



SHQIPTARËT DHE MODELI SOCIAL EVROPIAN

Drejt një ripërcaktimi të kontratës sociale

Sashenka Lleshaj
Alba Cela

Aiis



**FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG**

SHQIPTARËT DHE MODELI SOCIAL EVROPIAN

Drejt një ripërcaktimi të kontratës sociale



Tiranë, Tetor 2014

Botues: Friedrich-Ebert-Stiftung
Office Tirana
Rr. Abdi Toptani
Torre Drin, Kati i 3-te
Kutia Postare 1418
Tirane, Albania

Autorët: Sashenka Lleshaj
Alba Çela

Përpunimi i të dhënave: Güven Güneren

Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Fondacionit Friedrich Ebert.

Publikimet e Fondacionit Friedrich Ebert nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratim me shkrim.

Studimi që keni në dorë – Pjesë e një serie studimesh mbi aktorët e demokracisë shqiptare

Në fillim të vitit 2014, Fondacioni Friedrich-Ebert, sëbashku me ekspertët drejtues nga gjashtë organizata dhe Think Tanks të spikatura, solli në jetë një projekt afatgjatë. Qëllimi i këtij projekti është të gjallërojë dhe të nxisë diskutimin politik dhe shoqëror në Shqipëri mbi temën e integritimit në BE.

Një projekt afatgjatë në disa faza

Zanafilla e reflektimeve ishte perspektiva se Shqipëria së shpejti me një shoqëri sociale dhe ekonomike të zhvilluar dëshiron të jetë anëtare me të drejta të plota e BE-së. Më shumë se 80% e shqiptarëve e mbështesin këtë qëllim. Për të arritur këtë, Shqipërisë i duhet të përmbushë, ndër të tjera, edhe standardet minimale të BE-së — të ashtuquajturin Modelin Social Europian (MSE). **Këto standarde mund të arrihen vetëm nëse të gjitha grupet në shoqëri si edhe politika dhe administrata veprojnë bashkarisht, që do të thotë se ato ndërtojnë mes tyre një marrëdhënie besimi dhe bashkëpunimi.** Kërkesat e BE-së ndaj anëtarëve të saj të ardhshëm janë të larta dhe mund të përmbushen veçse përmes bashkëpunimit midis të gjithë pjesëmarrësve.

Për këtë arsye, ky projekt afatgjatë u planifikua në disa faza, të cilat pjesërisht duhet të ndërthuren me njëra-tjetrën për të mundur përfshirjen e rezultateve të diskutimit me aktorët në punën e mëtejshme të projektit. Nga ky këndvështrim, projekti mbetet dinamik dhe do të përfshijë edhe kontributin e atyre që marrin pjesë në diskutimet tona. Pika fillestare – faza e parë – ishte teza se një shoqëri demokratike dhe e suksesshme në aspektin ekonomik dhe social mund të zhvillohet vetëm nëse aktorët e saj veprojnë mbi bazën e besimit, orientimit demokratik dhe vullnetit për të bashkëvepruar në mënyrë aktive. Nëse bashkëpunimi

ndodh, anëtarësimi në BE do të vijë si “rezultat nga vetja”. Kjo është arsyeja pse këta aktorë u intervistuan në lidhje me raportet e tyre respektive ndaj parimeve të lartëpërmendura dhe grupeve të tjera të përfshira. Në këtë mënyrë, tri studime të ndryshme u krijuan.

Faza e parë: Studime mbi aktorët kryesorë

Studimi i parë është i bazuar mbi një sondazh përfaqësues të **popullsisë**, një aktor themelor ky për ndërtimin e marrëdhënieve demokratike. Studimi i dytë është i bazuar - në një sondazh me nëpunës të administratës publike në të gjitha nivelet e punësimit dhe në të gjitha rajonet e vendit — me vetë-konceptimin e **administratës** si një ofrues shërbimesh për qytetarët dhe shtetin. Studimi i tretë futet në zona të paeksploruara deri më tani. Duke pasur parasysh se **partitë politike** janë shtylla e demokracisë, u intervistuan anëtarë nga tri partitë politike të mëdha të përfaqësuara në parlament në lidhje me situatën aktuale dhe diskutimet brenda partive përkatëse. Edhe pse ky sondazh – për arsye që janë të kuptueshme – nuk mund të bazohet mbi të dhëna përfaqësuese, gjithsesi ofron një pamje të qartë të aktorëve politik kryesor.

Faza e dytë: Ngjashmëri dhe dallime - potencialet

Rezultatet e këtyre studimeve duhet të shikohen në ndërthurje me njëra-tjetrën për të hedhur dritë mbi mundësitë dhe pamundësitë e ndërveprimit të këtyre tri grupeve kryesore brenda demokracisë. Në këtë diskutim duhet të përfshihen gjetjet e debatit publik gjatë fazës së parë. Në një farë mase synohet të përpilohet një “**Manual për Debatin Publik mbi Demokracinë në Shqipëri**”. Ky titull pune nënkupton që libri ofron më pak përgjigje dhe rekomandime, por shumë më tepër shtron pyetje dhe jep sugjerime pasi procesi midis të gjithë aktorëve nuk është i kufizuar në kohë. Prosesi është vazhdimisht dinamik dhe aspekte të reja hynë gjithnjë në lojë.

Faza e tretë: Publiku – ligjërata, debate dhe diskutime

Debatet publike dhe eventet informuese – bazuar në gjetjet fillestare – e kompletojnë punën e projektit. Këto evente gjithashtu dhe veçanërisht zhvillohen për të përfshirë vazhdimisht gjetje dhe stimulime të reja në punën e projektit. Në total do të ketë debate në shkolla dhe universitete si dhe në median publike me përfaqësues nga të gjithë aktorët. Dokumentet e politikave që do të punohen do t'u shërbejnë në të njëjtën mënyrë debateve të rëndësishme politike dhe shoqërore.

Vetë rruga që ndjek projekti është pjesë e objektivit të tij: **përfshirja aktive e të gjithë aktorëve në një diskutim të përbashkët**. Qëllimi nuk është të gjenden zgjidhje shumë të shpejta apo të shkëmbehen vetëm deklarata, por më së shumti duhet të zhvillohet mirëkuptimi reciprok dhe të ndërtohet besimi. Me fjalë të tjera: kjo përpjekje mundohet, me anë të këtij zhanri të debatit publik, të **përmirësojë marrëdhëniet midis aktorëve – politikës, administratës dhe qytetarëve – si dhe të kontribuojë për një bashkëpunim më produktiv në ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe sociale**.

Faza e tretë është sigurisht e organizuar në një mënyrë, kohë dhe përmbajtje të hapur. Projekti në thelb aktivizohet më së shumti nga masa në të cilën aktorët në fjalë janë gati të përfshihen hapur në diskutim me idetë, kërkesat dhe dëshirat e tyre, me vizionet dhe frikërat e tyre.

Nga ky këndvështrim, projekti do të shoqërojë politikën shqiptare në një pjesë të rrugës së saj drejt BE-së si dhe do ta mbështesë atë. Një komponent i domosdoshëm i debateve demokratike është që kjo jo gjithmonë funksionon pa pengesa. Megjithatë, një gjë gjithnjë konfirmohet: miku më i mirë i një zhvillimi pozitiv është një dialog kritik dhe konstruktiv midis aktorëve që kanë respekt reciprok për njëri-tjetrin.

Tabela e Përmbajtjes

1. Hyrje	9
1.1. Rëndësia e këtij studimi	10
2. Përmbledhja e gjetjeve kryesore	13
3. Metodologjia dhe profili i të anketuarve	23
3.1. Metodologjia dhe kampionimi	23
3.2. Profili i të anketuarve	24
3.3. Cross-tabulimi dhe variacioni	29
4. Gjetjet dhe analiza	30
Nënkapitulli I:	
DEMOKRACIA DHE EKONOMIA E TREGUT	31
Nënkapitulli II:	
NIVELI I BESIMIT	47
Nënkapitulli III:	
KONTRATA KOLEKTIVE DHE DIALOGU SOCIAL	52
Nënkapitulli IV:	
SHËRBIMET PUBLIKE DHE ROLI I SHTETIT	56
Nënkapitulli V:	
SHANSET E BARABARTA DHE MBROJTJA SOCIALE	76
Nënkapitulli VI:	
VLERËSIMI I RISKUT	82
Aneksi 1: Pyetësi	85
Referencat	98

1. Hyrje

Euforia post-komuniste për ekonominë e tregut marxhinalizoi dimensionin social të shtetit pavarësisht faktit se qytetarët vazhdonin ta shikonin shtetin si ofruesin kryesor të shërbimeve sociale. Trashëgimia e marrëdhënies paternaliste me shtetin dhe ndjesia se qytetarët kanë të drejtë të kenë shërbime falas në edukim, kujdes shëndetësor, kujdes ndaj fëmijëve, etj, ishte veçanërisht prezente në Shqipërinë post-komuniste përgjatë periudhës së tranzicionit. Ndërkohë që demokracia liberale dhe ekonomia e tregut u panë si shtyllat kryesore të organizimit të shteti pas komunizmit, mendësia e qytetarëve në lidhje me shtetin, institucionet publike si dhe me shërbimet sociale nuk ndryshoi në mënyrë aq të shpejtë sa ndryshoi sistemi ekonomik përmes aplikimit të terapisë së shokut në fillim të viteve '90.

Megjithatë, kërkime të reja kanë treguar se pavarësisht faktit se trashëgimia komuniste është e rëndësishme në lidhje me qëndrimet e qytetarëve ndaj demokracisë, ekonomisë së tregut dhe institucioneve gjatë periudhës së tranzicionit, eksperiencia post-komuniste me institucionet dhe performanca e këtyre të fundit përgjatë kësaj periudhe i kanë ndikuar qëndrimet e qytetarëve po aq sa dhe trashëgimia komuniste. Kështu, disa do të argumentonin se eksperiencia e qytetarëve në periudhën post-komuniste ka qenë po aq e rëndësishme në përcaktimin e qëndrimeve të tyre politike sa dhe periudha komuniste. Për më tepër, performanca ekonomike dhe suksesi i institucioneve përgjatë tranzicionit kanë një korrelacion pozitiv me besueshmërinë e qytetarëve ndaj tyre.¹ Përmes së

1. Për më shumë mbi këtë qasje shiko: William Mishler and Richard Rose, "Trust, Distrust and Skepticism: Popular Evaluations of Civil and Political Institutions in Post-Communist Societies," *The Journal of Politics*, 59: 2, (May 1997): 418-51. Gjithashtu shiko: Grigore Pop-Eleches and Joshua A. Tucker, Communist Socialization and Post-Communist Economic and Political Attitudes, (Paper

njëjtës frymë variacioni, akademikë të tjerë kanë argumentuar se vendet post-komuniste nuk kanë lëvizur në të njëjtat shina gjatë tranzicionit duke parë eksperiencat e tyre të ndryshme në periudhën post-komuniste. Për shembull, vendet e Europës Qendrore dhe Lindore — të cilat u përfshinë në procesin e anëtarësimit në BE që në fazat e hershme të tranzicionit — i akomoduan më mirë nevojat dhe kërkesat e qytetarëve në një sistem të mirë-strukturuar të mirëqenies sociale krahasuar me vendet e tjera të rajonit.²

Ky variacion dy-dimensional i periudhës para dhe pas komuniste në njërën anë (variacioni kohor) dhe ndryshueshmëria e këtyre eksperiencave nga njëri vend në tjetrin përgjatë kësaj periudhe në anën tjetër (variacioni hapësinor), i bën përgjithësimet shumë të vështira ndërkohë që shtron nevojën e kërkimit të thelluar në lidhje me shtete të veçanta. Njëkohësisht, qasja e prezantuar më lart fton hulumtuesit të ndërmarrin më shumë punë kërkimore në lidhje me periudhën post-komuniste dhe me dizajnet e veçanta institucionale që ishin prezente gjatë periudhës së tranzicionit dhe që janë përgjegjëse në një masë të madhe për qëndrimet e qytetarëve.

1.1. Rëndësia e këtij studimi

Duke parë panoramën e paraqitur më lart me studime të zhvilluara kryesisht në Europën Qendrore dhe Lindore si dhe vendet post-sovjetike, ky anketim skicon panoramën e *qëndrimeve të përgjithshme të qytetarëve shqiptar* ndaj shtetit, institucioneve, shërbimeve publike, ofrimin privat përkundrejt atij publik të

prepared for presentation at the *Center for the Study of Democratic Politics*, Princeton University, May 9, 2012). <http://www.princeton.edu/csdp/events/Pop-Eleches05102012/Pop-Eleches05102012.pdf>.

2. Shiko Linda J. Cook, *Postcommunist Welfare States: Reform politics in Russia and Eastern Europe*. (Ithaca: Cornell University Press, 2007).

shërbimeve, si dhe nënvizon qëndrimet kryesore të qytetarëve ndaj shtetit të mirëqenies sociale, solidaritetit shoqëror, masës së ofrimit universal të shërbimeve, etj. Ky studim është i rëndësishëm për disa arsye:

Së pari, ky studim i shtohet një numri shumë të vogël anketimesh sociale të zhvilluara në Shqipëri. Ndërkohë që një gamë e gjerë anketimesh është zhvilluar në Shqipëri, anketimet sociale janë të limituara. Për t'u përmendur janë *Rinia Shqiptare 2011: Mes besimit për të ardhmen dhe dyshimit për të tashmen!*, *Gjendja e demokracisë shqiptare në prag të zgjedhjeve të përgjithshme 2013*, si dhe *Anketimi Social European (ESS) 2013* i zhvilluar nga OSF Shqipëri. Ky studim i shtohet kësaj serie ekzistuese si dhe e përdor atë si mjet krahasimor kur është e përshtatshme.

Së dyti, ky studim shkon përtej përpjekjeve të deritanishme në faktin që mundohet përmbledhtazi të adoptojë shtyllat kryesore të *Modelit Social European* (European Social Model) në një pyetësor të përshtatur kontekstit shqiptar. Modeli Social European përcaktohet në *Dokumentin e Bardhë të Politikës Sociale Europiane –Një mënyrë për të shkuar përpara për Bashkimin* të Komisionit European nga viti 1994, ku shtyllat kryesore të tij janë “demokraci dhe të drejta individuale, liri në dialogun kolektiv punëdhënës-punëmarrës, ekonomi tregu, të drejta të barabarta për të gjithë, si dhe mbrojtje sociale dhe solidaritet.”³ Modeli Social European është një kombinim unik që synon “t’i japë popullit të Europës përzierjen unike të mirëqenies ekonomike, kohezionit social dhe cilësisë së lartë të jetesës.”⁴ Kështu, Modeli Social European

3. Eurofund, *European Social Model*. (last updated: May 5, 2011). <http://www.eurofound.europa.eu/areas/industrialrelations/dictionary/definitions/europeansocialmodel.htm>

4. European Commission, *White Paper on European Social Policy - A Way Forward for the Union* (COM (94) 333, Brussels, July 27, 1994):1. http://aei.pitt.edu/1118/1/social_policy_white_paper_COM_94_333_A.pdf.

shërben si skelet për këtë anketë studimore duke qenë se përcakton seksionet e saj kryesore:

1. Demokracia dhe ekonomia e tregut;
2. Niveli i besimit;
3. Kontrata kolektive dhe dialogu social;
4. Shërbimet publike dhe roli i shtetit;
5. Shanset e barabarta dhe mbrojtja sociale;
6. Vlerësimi i riskut.

Së treti, ky studim mund t'u vijë në ndihmë politikë-bërësve në të ardhmen në momentin që ka nevojë për konsensus social mbi reforma sociale madhore apo për përpilimin e skemave të reja sociale. Edhe në momentin që flasim, çështje dhe diskutimet mbi shtetin e mirëqenies sociale janë mjaft relevante për Shqipërinë duke pasur parasysh vështirësitë ekonomike si dhe problemet e reja sociale në horizont, si për shembull plakja e popullsisë. Sidomos me nisjen e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian në të ardhmen e afërt, konsensusi kombëtar mbi reformat do të jetë një çështje kyçe. Disa raste të suksesshme nga Europa Qendrore dhe Lindore tregojnë se marrja në konsideratë e nevojave, opinionëve dhe pikëpamjeve të qytetarëve në momentin që vendoset mbi reformat themelore është jetësore për reforma të suksesshme dhe për anëtarësim të shpejtë në BE.

2. Përmbledhja e gjetjeve kryesore

Si i ndikon dizajni institucional qëndrimet e qytetarëve mbi çështje si demokracia, ekonomia e tregut, shanset e barabarta, mbrojtja sociale dhe solidariteti social? Cilat janë pikëpamjet e qytetarëve mbi shtetin e mirëqenies sociale? Cilat janë parimet kryesore që qëndrojnë në qendër të përgjigjeve të qytetarëve përgjatë sondazhit dhe si mund të përgjithësohen këto në nivel shoqëror? Këto janë disa çështje të përgjithshme që kjo përmbledhje ekzekutive do të mundohet të shtjellojë përmes raportimit të gjetjeve kryesore, përpara se të kalohet më tej tek metodologjia dhe gjetjet e analiza e detajuar. Secili nga seksionet e pyetësorit ka disa gjetje kryesore që janë të rëndësishme për t'u përmendur dhe diskutuar më në detaj. Për më tepër, ka disa gjetje ndër-seksionale të cilat janë veçanërisht të rëndësishme për t'u nënvizuar dhe diskutuar këtu.

“Është demokraci e pjesshme ajo në të cilën jetojmë”

Shumica e qytetarëve shqiptar që anketuam (72 përqind) besojnë se jetojnë në një *demokraci të pjesshme*, apo në atë çfarë studiuesit përcaktojnë si regjim hibrid. Si në rastin kur përgjigja është “Shqipëria është më tepër demokratike se jo demokratike”, ashtu dhe në rastin kur përgjigja është “Shqipëri është më tepër jo demokratike se demokratike”, qytetarët e perceptojnë nivelin e demokracisë në vend diku midis të qenit demokraci dhe jo demokraci. Megjithatë, është e rëndësishme të vihet re se një pjesë më e madhe të anketurve (43 përqind) besojnë që “Shqipëri është më tepër jo demokratike se demokratike”.

Ndërkohë që në sondazhin e vitit 2013⁵, një pjesë e mirë e përgjigjeve

5. Alba Çela dhe Joana Kosho. *Gjendja e demokracisë shqiptare në prag të zgjedhjeve të përgjithshme 2013*. Albanian Institute for International Studies and Friedrich Ebert Stiftung (Tiranë, 2013). Gjithashtu, shiko Grafikun 7 më kapitullin

pozicionohej në dy ekstremet: “Shqipëria është një vend plotësisht demokratik” dhe “Shqipëria është një vend plotësisht jo demokratik” — me 34 përqind të përgjigjeve — këtë vit, vetëm 20 përqind e përgjigjeve ra mbi këto dy ekstreme në një kohë që të anketuarit tentuan të pozicionoheshin më tepër drejt qendrës ku portretizohej një vend jo plotësisht demokratik. Kjo *lëvizje qendër synuese* është domethënëse pasi pikëpamjet e qytetarëve u zhvendosën nga cepat ekstrem të dikotomisë “plotësisht demokratike” kundrejt “plotësisht jo demokratike” drejt qasjes më të moderuar të dikotomisë “më shumë demokratike” kundrejt “më shumë jo demokratike”.

Perceptimet e qytetarëve shqiptar mbi formën e regjimit/nivelin e demokracisë duken konsistente me literaturën e gjerë mbi regjimet hibride, e cila në mënyrë të konsiderueshme e lidh periudhën e tranzicionit post-komunist me këtë formë regjimi.⁶ Megjithatë, popullariteti më i madh i këtyre pikëpamjeve në anketimin e vitit 2014 krahasuar me atë të vitit 2013 shtron disa pyetje të tjera për diskutim, kryesisht të lidhura me faktin nëse Shqipëria po del nga periudha e tranzicionit, apo nëse periudha e tranzicionit ka mbaruar tashmë por këto zhvillime duan më tepër kohë për t’u reflektuar në perceptimet qytetare. Nëse përfundimi i dytë do të vlente, centralizimi i pikëpamjeve i raportuar më sipër mund të shihet si një zhvillim pozitiv. Sigurisht ka vend për hulumtime të mëtejshme në lidhje me këto pika.

**“Ne duam një ekonomi tregu, por jo një ekonomi
të drejtuar nga tregu”**

Disa pikëpamje shumë interesante — nganjëherë dhe kontradiktore

më poshtë “Gjetjet dhe Analiza” ku gjetjet e vitit 2013 janë raportuar me qëllim krahasimin.

6. Për disa pikëpamje mbi Europën Qendrore dhe Lindore shiko: Elisabeth Bakke and Ingo Peters (eds.). *20 Years since the Fall of the Berlin Wall: Transitions, State Break-Up and Democratic Politics in Central Europe and Germany*. (Berlin: BWV Berliner Wissenschafts-Verlag, 2012).

— janë shprehur në lidhje me ekonominë e tregut dhe mënyrën sesi duhet të dizenjohet dhe të funksionojë ekonomia shqiptare. Nga përgjigjet e të anketuarve në disa pyetje mbi ekonominë e tregut, ndërhyrjen e shtetit në ekonomi, si dhe mbi rolin rregullues të shtetit në ekonomi apo rolin minimal të shtetit në ekonomi, është e udhës të thuhet që pikëpamjet e qytetarëve më së shumti përshkruajnë një *ekonomi mikse* si sistemin e duhur ekonomik për Shqipërinë, të paktën në parim. Kështu, shqiptarët duket se mbështesin një ekonomi ku shteti është i pranishëm në një masë të konsiderueshme.

Kur qytetarët u pyetën nëse *ekonomia e tregut* është ose jo sistemi i duhur ekonomik për Shqipërinë, shumica e tyre (65 përqind) u përgjigjën që është i duhuri. Në pyetjen pasardhëse, e cila kërkonte përgjigje nëse shteti shqiptar duhet të ndërhyjë në ekonomi për të përcaktuar çmimet, për të mbrojtur disa biznese strategjike, etj, më shumë se 2/3 e kampionit (71 përqind) u përgjigjën që shteti duhet të ndërhyjë. Për më tepër, 84 përqind e të anketuarve u përgjigjën që ata binin dakord me pohimin se “shteti shqiptar duhet të rregullojë marrëdhëniet ekonomike, rregullat e përgjithshme të konkurrencës dhe tregtisë, etj.” Në mënyrë që të konfirmohet përfundimi se qytetarët shqiptar do të preferonin në parim një ekonomi mikse, përgjigja ndaj pyetjes së fundit në lidhje me këtë temë është gjithashtu domethënëse. Kështu, një shumicë e konsiderueshme e të anketuarve (77 përqind) nuk ra dakord me pohimin se “shteti shqiptar duhet sa më pak të ndërhyjë dhe të jetë prezent në ekonomi, pasi ekonomia e tregut vetërregullohet.”

“Këto institucione nuk e meritojnë besimin tonë”

Ajo çfarë është menjëherë e dallueshme në nivelin e besimit të shqiptarëve ndaj institucioneve është *niveli i lartë i mosbesimit*. Ndërkohë që mosbesimi në institucionet publike ka qenë një simptomë e përhapur e tranzicionit post-komunist, mosbesimi ndaj institucioneve është akoma një fenomen i qëndrueshëm në

shoqërinë shqiptare. Institucionet më pak të mosbesuara (për pasojë më të besuarat) në vend — të cilat shënuan nivele të ulëta mosbesimi me më pak përgjigje “aspak” dhe “pak” dhe nivele të larta të përgjigjeve “disi” dhe “shumë” — janë institucionet publike të edukimit, spitalet private, policia dhe media. Në ekstremin tjetër, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, opozita dhe gjykatat shënuan një nivel shumë të lartë mosbesimi, ndërkohë që partitë politike janë në ekstrem të mosbesimit me 45 përqind të të anketuarve që shprehen se nuk kanë aspak besim në to. Spitalet publike gjithashtu shënuan nivele të ulëta besimi, me 59 përqind të të anketuarve që përgjigjen se kanë “pak” ose “aspak” besim në to.

Kur u pyetën veçanërisht në lidhje me gjykatat dhe gjendjen e tyre aktuale në dhënien e drejtësisë, qytetarët treguan një nivel të ulët besimi kundrejt sistemit të drejtësisë në Shqipëri. Kjo është e dukshme nëse i referohemi faktit se 60 përqind e të anketuarve ranë dakord me pohimet se “qytetarët duhet të kenë lidhje politike që të fitojnë drejtësi”, “qytetarët duhet të kenë miqësi personale për të fituar drejtësi” dhe “qytetarët duhet të paguajnë ryshfet/të korruptojnë gjyqtarët/prokurorët që të fitojnë drejtësi”. Njëkohësisht, 76 përqind e të anketuarve nuk ra dakord me pohimin se “sistemi gjyqësor në Shqipëri jep drejtësi”.

“Duam një shtet të gjithëpranishëm, pavarësisht se sa të kënaqur jemi me ofrimin e shërbimeve publike nga shteti”

Një trend i qëndrueshëm përgjatë sondazhit është tendenca e të anketuarve për të zgjedhur shtetin, institucionet publike dhe fondet/financimin publik si metodën e preferuar dhe më të përshtatshme për ofrimin e shërbimeve publike, pavarësisht faktit se përveç energjisë elektrike, për të gjitha shërbimet e tjera të ofruara nga shteti që ishin listuar në pyetësor më shumë se 50 përqind e qytetarëve u përgjigjën se janë “të pakënaqur” ose “jo shumë të kënaqur” me to (shiko grafikun 25). Kur qytetarët u pyetën se kush duhet të jetë

ofruesi kryesor i disa shërbimeve publike parësore, të anketuarit ishin relativisht të qëndrueshëm në opinionin se shteti duhej të ishte ofruesi kryesor.

Kështu, shteti ishte ofruesi i preferuar duke filluar nga punësimi me 66 përqind të përgjigjeve që zgjidhnin shtetin si ofrues deri tek siguria publike me 91 përqind të të anketuarve që mendonin se shteti duhet të jetë ofruesi kryesor i këtij shërbimi. Për shërbime të tjera si drejtësia, edukimi, mbrojtja sociale, kujdesi shëndetësor, infrastruktura, energjia elektrike, furnizimi me ujë, shërbimi postar dhe strehimi shteti zgjidhej si ofruesi kryesor nga shumica dërrmuese në vlera nga 66 deri në 91 përqind të përgjigjeve (grafiku 21). Për më tepër (grafiku 31), midis 70 dhe 90 përqind e të anketuarve u përgjigjën që shteti duhet të sigurojë shërbime kujdesi për fëmijët, asistencë papunësie, leje lindjeje të paguar, kujdes shëndetësor të përshtatshëm si dhe 91 përqind e të anketuarve u përgjigjën që shteti duhet të sigurojë asistencë për personat me aftësi të kufizuara.

Të pyetur në mënyrë specifike për edukimin, kujdesin shëndetësor dhe pensionin, shumica e të anketuarve u përgjigjën që si edukimi ashtu dhe kujdesi shëndetësor në Shqipëri duhet të jenë “publik dhe i financuar nga taksat publike”, ndërkohë që pensionet duhet të jenë “të menaxhuara nga sektori publik dhe të financuara nga kontributet sociale, por t’u jepet e drejta e zgjedhjes atyre që duan të kontribuojnë pjesërisht në skema private pensionesh”.

Gjithashtu, institucionet publike janë cilësuar si ofrues *më të mirë* të shërbimeve publike (grafiku 26), me përjashtim të kujdesit shëndetësor dhe nxitjes së punësimit, ku sektori privat shikohet si ofrues më i mirë.

Së fundmi, ndërkohë që shumica e të anketuarve (66 përqind) mendojnë se privatizimi i bën ndërmarrjet shtetërore më efektive në ofrimin e shërbimeve, edhe më shumë të intervistuar (72

përqind) mendojnë se jo të gjitha ndërmarrjet shtetërore në Shqipëri duhet të privatizohen. Duket se zgjidhja e preferuar për qytetarët — me 70 përqind të përgjigjeve — do të ishte aplikimi i një modeli ku shteti vazhdon të jetë pronari i ndërmarrjeve të rëndësishme ndërkohë që kompanitë private kontraktohen vetëm për pjesën e menaxhimit.

“Shërbimet duhet të jenë publike⁷ edhe pse ne nuk jemi të sigurtë nëse jemi të gatshëm për të paguar më shumë taksa”

Zakonisht, sipas disa modeleve perëndimore të mirëqenies sociale (modeli Nordik), ndodh që një sasi më e madhe dhe një cilësi më e mirë e ofrimit të shërbimeve publike nga shteti bashkërendohet me një nivel më të lartë taksimi. Siç dhe u përmend më lart, edhe pse shqiptarët kërkojnë një shtet gjithëprezent në shërbimet publike, ata janë të pavendosur nëse janë gati të paguajnë më shumë për shërbime më të mira/më gjithëpërfshirëse. Kështu, 49 përqind e të anketuarve bien dakord që “niveli i taksave duhet të rritet nëse kjo gjë do të rriste cilësinë e shërbimeve” kundrejt 51 përqind e tyre që janë kundër këtij pohimi.

Ndonëse të anketuarit janë të pavendosur nëse janë të gatshëm të paguajnë më shumë për shërbime më të mira, shumica (70 përqind) bie dakord që “kush fiton më shumë duhet të paguajë më shumë” dhe 62 përqind nuk bien dakord që “taksat mbi të ardhurat duhet

7. “Publike” në këtë rast i referohet aksesit universal në shërbime të ofruara nga shteti. Diferenca “publike” kundrejt “private” në këtë studim bëhet sipas kuptimit të përgjithshëm në Shqipëri — ofrim i shërbimeve nga shteti të aksesueshme për të gjithë, kundrejt ofrimit të shërbimeve nga një njësi private të aksesueshme në varësi të një vlere monetare. Kjo diferencë “publike” kundrejt “private” nuk do të kishte kuptim në një kontekst anglosakson, ku për shembull universitetet, spitalet, apo kopshtet e fëmijëve konsiderohen publike, pavarësisht faktit që akses i ndaj tyre sigurohet kundrejt një vlere monetare. Si pasojë e hapësirës së limituar, ky është sigurisht një shpjegim shumë i thjeshtëzuar i një fenomeni kompleks dhe kuptueshmërisë së këtyre termave në shoqëri të ndryshme.

të kenë një përqindje fikse pavarësisht nga niveli i të ardhurave”. Nga përgjigjet e të anketuarve mund të arrihet në konkluzionin se qytetarët do të preferonin një taksim progresiv në raport me taksimin e sheshtë dhe që hendeuku social duhet të reduktohet nga taksat/kontributet më të mëdha të atyre që fitojnë më shumë.

“Vendimmarrja me shumë aktorë në lidhje me shërbimet publike është e dëshirueshme, por nuk po aplikohet”

Si duhet të merren vendimet mbi shërbimet publike dhe nga kush? Në lidhje me aktorët vendimmarrës qytetarët e shikojnë shtetin si një vendimmarrës të rëndësishëm, por jo të vetmin. Ata e shikojnë komunitetin dhe sindikatat si aktorë njësoj të rëndësishëm dhe legjitim në diskutimin dhe vendimmarrjen mbi çështje të rëndësishme në lidhje me shërbimet publike. Me pak fjalë, qytetarët cilësojnë si model optimal *vendimmarrjen me shumë aktorë* në lidhje me shërbimet publike.

Të pyetur se përgjegjësia e kujt duhet të jetë vendimmarrja mbi menaxhimin dhe prioritetet e shërbimeve publike, më shumë se gjysma (58 përqind) u përgjigjën që vendime të tilla duhet të merren “nga ekspertët dhe politikë-bërësit në bashkëpunim me publikun e gjerë apo grupet komunitare, të cilat përfitojnë dhe kontribuojnë për këto shërbime”. Nga pjesë e mbetur, 1/4 e të anketuarve u përgjigj se “komuniteti dhe publiku në përgjithësi duhet të jenë shumë më të përfshirë në formësimin e këtyre shërbimeve duke u treguar prioritetet politikë-bërësve”.

Për më tepër, kur qytetarët u pyetën se kush duhet të jetë përgjegjës për marrjen e vendimeve të rëndësishme mbi pagat, orët e punës dhe të drejtat e të punësuarve në Shqipëri, një shumicë e konsiderueshme e të anketuarve (61 përqind) u përgjigj se “duhet të diskutohen dhe vendosen nga qeveria/politikë-bërësit në bashkëpunim me sindikatat/organizatat e punëtorëve”. Gjithashtu, 1/5 e të anketuarve u përgjigj që këto vendime “duhet të diskutohen dhe vendosen kryesisht nga

sindikatat/organizatat e punëtorëve ndërkohë që qeveria/politikë-bërësit janë pjesa fundore e procesit”. Vetëm 12 përqind u përgjigj se këto vendime “duhet të diskutohen dhe vendosen vetëm nga institucionet publike dhe qeveria/politikë-bërësit”.

Pavarësisht këtyre pikëpamjeve mbi procesin optimal, shumica e qytetarëve ndjen se ka pak ose aspak ndikim mbi vendimmarrjen në nivel lokal dhe/ose qendror. Kështu, 80 përqind e të anketuarve u përgjigjën se kanë “pak” ose “aspak” ndikim mbi procesin vendimmarrës në nivel lokal dhe 89 përqind u përgjigjën njësoj në lidhje me procesin vendimmarrës në nivel qendror. Në të njëjtën mënyrë, veprimtaria e sindikatave në Shqipëri është përgjithësisht e panjohur nga qytetarët — një detaj ky që tregon shumë për angazhimin e tyre të ulët publik. Kështu, 86 përqind e të anketuarve nuk ishin në gjendje të binin dakord ose jo me pohimin se sindikatat sot janë “aktive dhe efektive në mbështetjen e të drejtave të punëtorëve”.

“Dua një shoqëri më të drejtë dhe më solidarë”

Duke gjykuar nga ky sondazh duket se shumica e qytetarëve shqiptar do të donte të jetonte në një shoqëri që ofron mbrojtje të konsiderueshme sociale dhe që drejtohet nga solidariteti. Kjo është fillimisht e dukshme kur qytetarëve iu kërkua të *përkufizonin një shoqëri të drejtë* dhe ata ishin kryesisht të ndarë midis dy pohimeve: në një shoqëri të drejtë “kush paguan më shumë merr më shumë, por disa grupe të dobëta të shoqërisë duhet të asistohen nga shteti” dhe “askush nuk lihet pa shërbime publike bazë, pavarësisht nga aftësia për të kontribuar” — ku të dy këto pohime u zgjodhën secili nga 36 përqind e të anketuarve.

Për më tepër, kur qytetarët u pyetën në mënyrë specifike mbi *asistencën e papunësisë* në Shqipëri, një shumicë e konsiderueshme (83 përqind) u përgjigj se asistenca që jepet aktualisht është shumë e vogël. Dy pohimet e tjera — që thonin se asistenca e papunësisë është e lartë ose në nivelin e duhur — u zgjodhën nga shumë pak të

intervistuar në krahasim me pohimin e mësipërm.

Më lart u nënvizua fakti që qytetarët shqiptar preferojnë një shtet aktiv dhe të gjithpranishëm që kujdeset për shumë aspekte të jetës së qytetarëve. Duke vazhduar në të njëjtën temë, shumica e të anketuarve (nga 72 përqind deri në 91 përqind) do të donte që shteti të ishte aktiv në ofrimin e shërbimeve për njerëzit me aftësi të kufizuara, prindërit që punojnë, familjet e varfra, pensionistët, etj. Për më tepër, 43 përqind e të anketuarve mendon se shteti shqiptar duhet të “ketë një rol aktiv rishpërndarës në mënyrë që të zvogëlojë diferencën/hendekun midis të pasurve dhe të varfërve” dhe 35 përqind mendon se shteti “duhet të angazhohet në një masë të moderuar në politikat rishpërndarëse”. Vetëm 12 përqind mendon se “diferenca/hendeku midis të pasurve dhe të varfërve nuk është një çështje që duhet ta zgjidhë shteti”.

“Ne të gjithë kemi probleme të ngjashme”

Një tjetër temë e pranishme në studim — veçanërisht e dukshme në seksionin e fundit të pyetësorit mbi vlerësimin e riskut — është fakti që të anketuarit i perceptojnë problemet më të mëdha që kanë aktualisht si të ngjashme me problemet që ata mendojnë se kanë shqiptarët e tjerë. Kështu, kur të anketuarit pyeten mbi problemet që kanë sipas tyre qytetarët shqiptar sot, më të zgjedhurat janë papunësia, varfëria dhe standardet e ulëta të drejtësisë. Në mënyrë të ngjashme, kur pyeten mbi problemet personale më shqetësuese, shumica e përgjigjeve zgjedhin të ardhurat e pakta, papunësinë dhe varfërinë. Duke gjykuar nga simetria e këtyre përgjigjeve, mund të konkludojmë se ka një farë kohezioni social në lidhje me atë çfarë qytetarët shikojnë si bashkërisht problematike apo si një element përbashkues në jetën e tyre të përditshme.

**Nuk ka ndarje të qartë ideologjike në të majtë apo të djathtë
në Shqipëri**

Ndërsa qytetarët në Shqipëri do ta identifikonin veten se i përkasin krahut të djathtë apo të majtë në varësi të partisë të cilën simpatizojnë, në terma ideologjik duket se nuk ka një ndarje apo përkatësi të qartë në Shqipëri. Nga *cross-tabulimet* e prezantuara në Kapitullin 4 mund të dallohet që në lidhje me pyetje që konsiderohen si të ndjeshme ideologjiksht mbi shtetin, ekonominë apo shtetin e mirëqenies sociale, përgjigjet nuk përputhen me pritshmëritë sipas profilin ideologjik. Ndërkohë që të anketuarit që i përkasin së majtës, qendrës dhe qendrës së djathtë kanë tendencën të jenë më konsistent me qëndrimet tradicionale të profilin të tyre ideologjik, ata që identifikohen si të djathtë janë krahasimisht më jo konsistentët në përgjigjet e tyre duke gjykuar nga pritshmëritë në lidhje me profilin ideologjik.

Niveli i të ardhurave është i rëndësishëm në përcaktimin e një pjese të qëndrimeve të qytetarëve

Përgjatë sondazhit vumë re se niveli i të ardhurave ishte zakonisht më i rëndësishëm se profili ideologjik në përcaktimin e përgjigjeve të të anketuarve. Kështu, kur qytetarët u pyetën në lidhje me ndërhyrjen e shtetit në ekonomi, modelet e vendimmarrjes, menaxhimi privat kundrejt atij publik për edukimin, shëndetësinë, pensionet, taksimin apo privatizimin, të ardhurat duket të jenë një variabël i rëndësishëm që ndikon përgjigjet/qëndrimet. Edhe pse nuk mund të flasim për marrëdhënie shkakësore në këtë pikë — si dhe do të jetë e dukshme në Kapitullin 4 — ka një nivel korrelacioni midis të ardhurave dhe përgjigjeve të qytetarëve në lidhje me disa pyetje.

3. Metodologjia dhe profili i të intervisturve

3.1. Metodologjia dhe kampionimi

Ky pyetësor pati një kampion prej 1200 të anketuarish dhe synoi të kishte një shumëllojshmëri profilesh të anketuarish në lidhje me gjininë, moshën, nivelin e edukimit, statusin e punësimit si dhe në lidhje me nivelin e të ardhurave dhe profilin ideologjik; pavarësisht se disa nga këtë karakteristika nuk mund të paracaktoheshin duke qenë se zgjedhja e të intervistuarve ishte rastësore me kuotim paraprak në varësi të numrit të popullsisë së 12 njësive administrative të Shqipërisë. Pyetësi u zhvillua me anketa gjatë muajve maj-qershor 2014, në zonat më të mëdha urbane të 12 njësive administrative.⁸

Kjo shtrirje e njësive të kampionimit është e përshtatshme për të eksploruar disa modele kryesore të perceptimeve dhe pritshmërive të qytetarëve në lidhje me demokracinë, ekonominë e tregut, institucionet publike dhe private si dhe në lidhje me shtetin e mirëqenies sociale në Shqipëri. Për pasojë, me këtë gamë të gjerë të dhënash me shtrirje horizontale dhe vertikale, analiza do të jetë në gjendje të eksplorojë variacionin e mundshëm të qëndrimeve të qytetarëve në lidhje me variabla specifike siç janë niveli i të ardhurave dhe profili ideologjik.

Si dhe u përmend në hyrje, konceptimi i seksioneve të pyetësorit është bërë sipas shtyllave kryesore të Modelit Social European. Kapitulli i fundit që trajton vlerësimin e riskut është lënë qëllimisht në fund si seksion përmbyllës në mënyrë që politikë-bërësit dhe studime të tjera të mund të vazhdojnë prej aty si një pikë fillimi për kërkime të mëtejshme ose përpilime politikash.

8. Shiko Shtojcën 1 për formatin e pyetësorit.

Në lidhje me pyetjet specifike, pyetësi ka huazuar skeletin konceptual të pyetjeve nga anketa të mirënjohura sociale duke bërë përshtatjet e nevojshme për kontekstin shqiptar. Një burim i rëndësishëm për këtë qëllim ishte Sondazhi Social European⁹ tashmë ndër më të cituarit për çështjet sociale, Qendra Spanjolle për Kërkime Sociologjike (CIS),¹⁰ 2020 Fondi i Shërbimeve Publike,¹¹ si dhe pyetje të huazuara nga pyetësorë të mëparshëm, sidomos ato mbi nivelin e besimit dhe vlerësimin e riskut.

Me një kampionim të tillë përfaqësues, edhe pse përgjatë gjetjeve dhe analizës raporti u referohet kampionit dhe të anketuarve, jemi statistikisht në gjendje të përgjithësojmë për popullsinë më të gjerë dhe t'u referohemi qytetarëve shqiptar.

3.2. Profili i të anketuarve

Nga grafikët e mëposhtëm (grafiku 1 dhe 2) vihet re se kampioni i këtij sondazhi është i përbërë nga 52 përqind femra dhe 48 përqind meshkuj.¹² Në lidhje me *moshën*, kampini varion nga 18-29 vjeç deri në mbi 70 vjeç. Kompozimi shumëngjyrësh i grafikut të moshës tregon se edhe grupet moshore ishin të balancuara në kampion ku dy grupet më të mëdha ishin 18-29 vjeç (38 përqind e kampionit) dhe


9. European Social Survey. *Data and Documentation*. (2014). <http://www.europeansocialsurvey.org/data/>. Një model pyetësi gjendet këtu: http://www.europeansocialsurvey.org/docs/round6/fieldwork/source/ESS6_source_main_questionnaire.pdf.

10. Shiko Inés Calzada dhe Eloísa del Pino. Perceived efficacy and citizens' attitudes toward welfare state reform. *International Review of Administrative Sciences*. Volume 74:4. (2008). pp. 555-574.


11. 2020 Public Services Trust at RSA. *What do people want, need and expect from public services?* (2010). http://www.ipsos-mori.com/DownloadPublication/1345_sri_what_do_people_want_need_and_expect_from_public_services_110310.pdf.

12. Shënim mbi vlerat në përqindje: Përgjatë raportit vlerat në përqindje janë rrumbullakosur në vlera të plota, kështu asnjë vlerë nuk është lënë pas presjes dhjetore.

30-39 vjeç (24 përqind e kampionit). Është e dukshme që kampioni është relativisht i ri me të paktën 80 përqind të tij që i përket moshës nën 50 vjeç.




Grafiku 1



Grafiku 2


Ndërkohë që gjinia dhe mosha janë variabla të rëndësishëm për të prezantuar profilin e përgjithshëm të kampionit, *niveli i edukimit* dhe *statusi i punësimit* janë disa variabla të tjerë edhe më të rëndësishëm për të detajuar më vonë qëndrimet e qytetarëve në këtë sondazh social. Këta janë variabla që mundet potencialisht të përcaktojnë zgjedhjet e qytetarëve në lidhje me pyetësorin, duke qenë se si edukimi ashtu edhe statusi i punësimit — të kombinuara apo veçmas — ndikojnë ose përcaktojnë vlerat dhe pikëpamjet e njerëzve mbi çështje sociale dhe politike.

Për sa i përket edukimit, kampioni ka një grup relativisht të madh të intervistuarish me edukim universitar, të cilët përbëjnë 40 përqind të tij. Pas tyre vijnë të edukuarit me arsim të mesëm që përbëjnë 35 përqind dhe 13 përqind e të anketuarve kanë një edukim të nivelit master apo doktorat.



Grafiku 3

Për sa i përket statusit të punësimit, më shumë se gjysma e kampionit është i përbërë nga individë të punësuar, ndërkohë që 19 përqind janë studentë, 16 përqind janë të papunë dhe 9 përqind janë pensionistë.



Grafiku 4

Sipas literaturës mbi mirëqenien sociale në përgjithësi dhe sistemin e mirëqenies sociale në vendet post-komuniste në veçanti,¹³ *niveli i të ardhurave* është ndër variablat kryesor në përcaktimin e perceptimeve, pritshmërive dhe qëndrimeve të njerëzve në lidhje me institucionet publike, rolin e shtetit në

13. Shiko Richard Rose dhe Toni Makkai. "Consensus or dissensus about welfare in post-communist societies?", *European Journal of Political Research*, Volume 28: 2, (September 1995): 203–224.

ekonomi, profilin e një shoqërie të drejtë, etj. Kështu, ky variabël së bashku me profilin ideologjik, bëhet mjaft i rëndësishëm për të analizuar përgjigjet e të anketuarve në këtë sondazh.

Profili ideologjik presupozohet të jetë i përputhshëm me statusin ekonomik dhe social, një status ky që në këtë sondazh pjesërisht mund të përfaqësohet nga niveli i të ardhurave. Literatura e gjerë mbi qëndrimet politike në post-komunizëm dhe mbi thyerjet/ndarjet shoqërore në përgjithësi nënvizon faktin se në këto vende, vetë-identifikimi i individëve në spektrin ideologjik nuk përcaktohet në varësi të nivelit të të ardhurave siç mund të pretendohet duke u nisur nga tradita e shoqërive perëndimore.¹⁴ Pavarësisht këtyre pikëpamjeve, sipas Pop-Eleches dhe Tucker,¹⁵ njerëzit në shoqëritë post-komuniste, gjatë këtyre viteve të fundit, priren ta identifikojnë veten gjithnjë e më tepër në spektrin ideologjik (i ashtuquajtur i vetë-identifikim në spektrin e majtë-e djathtë) në varësi të profilit të tyre ekonomik, pra të ardhurave.


Në lidhje me nivelin e të ardhurave familjare,¹⁶ është e dukshme se më shumë se gjysma e të anketuarve (60 përqind) deklarojnë se niveli i agreguar i të ardhurave të tyre familjare në muaj është më i vogël ose i barabartë me 60 mijë Lekë. Për më tepër, 34 përqind deklaruan një nivel të ardhurash midis 60 mijë dhe 160 mijë Lekë në muaj, ndërkohë që 4 përqind deklaruan se të

14. Hulda Thorisdottir, John T. Jost, Ido Liviatan dhe Patricke Shrout. "Psychological Needs and Values Underlying Left-Right Political Orientation: Cross-National Evidence from Western and Eastern Europe." *Public Opinion Quarterly* 71:2 (2007), pp. 175-203.

15. Grigore Pop-Eleches dhe Joshua A. Tucker. Communist Socialization and Post-Communist Economic and Political Attitudes. (Paper prepared for presentation at the *Center for the Study of Democratic Politics, Princeton University*, May 9, 2012). <http://www.princeton.edu/csdp/events/Pop-Eleches05102012/Pop-Eleches05102012.pdf>.

16. Marrim parasysh faktin që në sondazhe të tilla, të anketuarit jo gjithmonë e deklarojnë të saktë nivelin e të ardhurave.


ardhurat e tyre familjare i kalojnë 160 mijë Lekë.



Grafiku 5¹⁷

Kur vijmë tek vetë-identifikimi në spektrin ideologjik, një numër i konsiderueshëm i të anketuarve (26 përqind) nuk e përcaktuan veten në terma ideologjik, duke zgjedhur opsionin “asnjë” si përgjigje. Për më tepër, 9 përqind e të intervistuarve zgjodhën të mos i japin një përgjigje kësaj pyetjeje. Nëse këto dy kategori kombinohen, atëherë nuk ka një informacion mbi spektrin ideologjik të më shumë se 1/3-ës së kapionit (35 përqind). Përtej kësaj, të anketuarit e tjerë ishin të shpërndarë në spektrin politik në mënyrë të konsiderueshme. Kështu, kategoritë kryesore ishin e majta me 23 përqind dhe e djathta me 15 përqind. Nëse qendra e majtë dhe e djathtë merren në konsideratë në një ndarje binare, atëherë e majta përbën 1/3-ën e kampionit (33 përqind) dhe e djathta përbën pothuajse 1/4-ën e kampionit (23 përqind).

17. Shënim mbi të ardhurat: Pse njerëzit u pyetën mbi të ardhurat familjare dhe jo ato personale? Niveli personal i të ardhurave mendohet të jetë po aq i rëndësishëm sa niveli familjar i të ardhurave në literaturën për shoqëritë post-komuniste, e sidomos ato më konservatore ku familja është mbështetësja kryesore e pjesëtarëve të saj. Kjo sjell në fokus problemin tjetër të numrit të pjesëtarëve të familjes, por duke u nisur nga pyetësorë të mëparshëm mendojmë se numri i pjesëtarëve në familjen bërthamë në Shqipëri, sidomos në zonat urbane, nuk varion në mënyrë të konsiderueshme.



Grafiku 6

3.3. Cross-tabulimi dhe variacioni

Përgjatë analizës së gjetjeve në kapitullin pasardhës, janë përpiluar *cross-tabulimet* e variablave në mënyrë që të shikohet sesi profili i të anketuarve ka ndikuar përgjigjet dhe qëndrimet e tyre në lidhje me çështjet më të rëndësishme. Gjatë analizës është veçanërisht interesantë të shikohet variacioni i përgjigjeve në varësi të profilit ideologjik dhe në varësi të të ardhurave të të anketuarve. Siç dhe u theksua më sipër, sipas literaturës këta dy variabla kanë tendencën të ndikojnë pikëpamjet e individëve në lidhje me rolin e shtetit në ekonomi, politikat rishpërndarëse, shtetin e mirëqenies sociale dhe karakteristikat e tij, etj. Në kapitullin pasardhës, këto rezultate do të raportohen pas atyre pyetjeve ku ka variacione domethënëse në lidhje me të ardhurat dhe profilin ideologjik.

4. Gjetjet dhe analiza

Ky kapitull është organizuar në gjashtë nënkapituj që përfaqësojnë gjashtë seksionet e pyetësorit, që janë: (1) Demokracia dhe ekonomia e tregut; (2) Niveli i besimit; (3) Kontrata kolektive dhe dialogu social; (4) Shërbimet publike dhe roli i shtetit; (5) Shanset e barabarta dhe mbrojtja sociale; dhe (6) Vlerësimi i riskut. Pyetjet në brendësi të këtyre kategorive të përgjithshme synojnë të prezantojnë një panoramë relativisht të detajuar të gjendjes së shtetit të mirëqenies sociale në Shqipëri, të shërbimeve publike dhe prezencës së shtetit, si dhe të qëndrimeve dhe pritshmërive të qytetarëve në raport me to.

Njëkohësisht, përgjatë nënkapitujve do të raportohet dhe analizohet variacioni i përgjigjeve në varësi të të ardhurave dhe profilit ideologjik. Cross-tabulimi i variablave do të raportohet dhe diskutohet në ato raste kur është vënë re një variacion domethënës në lidhje me të ardhurat dhe profilin ideologjik.

Përgjatë analizës, në disa raste do të ketë krahasime me dy sondazhe të mëparshme: *Rinia Shqiptare 2011: Mes besimit për të ardhmen dhe dyshimit për të tashmen!*, dhe *Gjendja e demokracisë shqiptare në prag të zgjedhjeve të përgjithshme 2013*; ku një pjesë e vogël nga pyetjet që po trajtojmë janë të ngjashme, edhe pse asnjë nga këta pyetësorë të mëparshëm nuk kishte profil dhe qëllime të njëjta me këtë sondazh.

Nënkapitulli I: DEMOKRACIA DHE EKONOMIA E TREGUT


Ky seksion nënvizon qëndrimet dhe parimet kryesore të qytetarëve në lidhje me gjendjen aktuale të demokracisë, ekonomisë së tregut, shtetit ligjor dhe perceptimet e qytetarëve mbi ndikimin e tyre në vendimmarrjen në Shqipëri. Ndërkohë që demokracia në vetvete nuk është pyetur në mënyrë të detajuar përveç pyetjes së parë, parimet e përgjithshme mbi ekonominë e tregut shërbejnë si pyetje të rëndësishme hyrëse për pyetësoin në mënyrë që të përcaktohen pikëpamjet e përgjithshme, besimet dhe parimet politike të të anketuarve në raport me shtetin dhe rolin e tij në ekonomi. Për më tepër, përgjigjet e qytetarëve rreth përgjegjësisë vendimmarrëse mbi menaxhimin dhe shpërndarjen e shërbimeve publike si dhe mbi nivelin e ndikimit që ata kanë mbi vendimmarrjen në nivel lokal dhe qendror është një indikator i mirë për të matur në terma të përgjithshëm nivelin e perceptuar të demokracisë vendimmarrëse ndër qytetarë.

Në përgjigje të një pyetjeje të rëndësishme hyrëse për këtë sondazh, mbi *nivelin e demokracisë në vend*, të anketuarit ishin të ndarë kryesisht midis opinionit se “Shqipëria është më shumë jo demokraci sesa demokraci”, me 43 përqind të përgjigjeve, dhe “Shqipëria është më shumë demokraci sesa jo demokraci”, me 29 përqind. Siç dhe mund të shihet më poshtë në grafikun 7, vlerat nga ky sondazh i vitit 2014 janë të krahasueshme me vlerat e vitit 2013 nga sondazhi *Gjendja e demokracisë shqiptare në prag të zgjedhjeve të përgjithshme 2013*.¹⁸

E rëndësishme për t’u nënvizuar në këtë rast është fakti se, ndërkohë që pjesa e atyre që mendonin se “Shqipëri është një

18. Alba Çela dhe Joana Kosho, 2013: 33.


vend plotësisht jo demokratik” ra me 10 përqind nga viti 2013 në vitin 2014, pjesa e atyre që mendonin se “Shqipëria është më shumë jo demokraci sesa demokraci” u rrit me 7 përqind. Në të njëjtën mënyrë, ndërkohë që pjesa e atyre që mendonin se “Shqipëria është një vend plotësisht demokratik” ra me 4 përqind, pjesa e atyre që mendonin se “Shqipëria është më shumë demokraci sesa jo demokraci” u rrit me 8 përqind. Kështu, në vitin 2014 ka një zhvendosje të dukshme të qytetarëve drejt vlerave të moderuara të mesme të *‘demokracisë së pjesshme’* me 72 përqind të përgjigjeve që gjenden në këtë kategori, kundrejt 57 përqind të vitit të kaluar. Pra, një lëvizje qendërsynuese është prezente në pikëpamjet e qytetarëve, e cila tenton të lëvizë nga ekstremet drejt një pikëpamjeje më të moderuar dhe komplekse të sistemit politik në Shqipëri.



Grafiku 7

Kur qytetarët u pyetën nëse *ekonomia e tregut* është sistemi i duhur ekonomik për Shqipërinë, shumica e të intervistuarve, 65 përqind, u përgjigjën që është. Nga ana tjetër, 1/5 e kampionit (21 përqind) mendojnë të kundërtën. Ndërkohë që për një shoqëri post-komuniste në parim këto përqindje duken të kuptueshme


dhe ‘normale’, dy pyetjet në vijim — të cilat shërbejnë edhe si pyetje testuese për këtë të parën — dëshmojnë për një panoramë më të ndërlikuar të qëndrimeve dhe perceptimeve të qytetarëve në Shqipëri.



Grafiku 8


Variacioni në varësi të të ardhurave dhe profilit ideologjik

Ndërkohë që grafiku i mësipërm paraqet panoramën e përgjithshme të përgjigjeve, grafiku 8.1 ndihmon për të kuptuar më mirë variacionin e përgjigjeve në varësi të të ardhurave të të anketuarve. Grafiku tregon se të anketuarit me të ardhura më të larta kanë tendencë të jenë më shumë dakord me pohimin se ekonomia e tregut është sistemi i duhur ekonomik për Shqipërinë, edhe pse nuk mund të flasim për një korrelacion të qartë. Kështu, kur shkojmë nga niveli i të ardhurave ‘0-30 mijë Lekë’ në ‘100-160 mijë Lekë’ të anketuarit kanë tendencën të bien më shumë dakord me pohimin se ekonomia e tregut është sistemi i duhur ekonomik për Shqipërinë (përqindja rritet gradualisht nga 53 në 82). Deri këtu korrelacioni është i qëndrueshëm. Korrelacioni nuk është i plotë duke qenë se kur arrijmë tek niveli i të ardhurave ‘mbi 160 mijë Lekë’ ky trend nuk vazhdon.



Grafiku 8.1


Nëse shikojmë profilin ideologjik të të anketuarve dhe përgjigjet e tyre ndaj së njëjtës pyetje vërejmë se nuk ka një ndarje të qartë ideologjike në lidhje me këtë pyetje. Nga grafiku më poshtë vërehet se ‘qendra e djathtë’ ngjan më tepër me të djathtën, ndërkohë që të anketuarit që identifikohen si ‘të majtë’ apo ‘qendër e majtë’ mbështesin ekonominë e tregut më tepër se ata të anketuar që identifikohen si ‘të djathtë’ (74 përqind dhe 75 përqind kundrejt 67 përqind).



Grafiku 8.2

Ndërhyrja e shtetit në ekonomi — edhe pse kjo mund të bëhet në grada të ndryshme dhe duke ndjekur modele të ndryshme të ndërhyrjes së shtetit — konsiderohet përgjithësisht si një parim shumë i ndryshëm ekonomik krahasuar me ekonominë e tregut. Kur përgjigjen nëse shteti në Shqipëri duhet të ndërhyjë ose jo në

ekonomi për të përcaktuar çmimet, për të mbrojtur disa biznese strategjike, etj, më shumë se 2/3 e kampionit përgjigjet që shteti duhet të ndërhyjë dhe 29 përqind mendojnë të kundërtën. Nëse këto përgjigje krahasohen me pyetjen paraardhëse në lidhje me ekonominë e tregut, përgjigja nuk duket shumë konsistente. Megjithatë, mënyra sesi pyetja është formuluar “shteti në Shqipëri duhet të ndërhyjë në ekonomi për të përcaktuar çmimet, për të mbrojtur disa biznese strategjike, etj” mund të tingëllojë si kapitalizëm i moderuar për një shoqëri post-komuniste. Ky do të ishte rasti nëse marrim në konsideratë faktin se e kundërta e ekonomisë së tregut në Shqipëri do të ishte një sistem që i përngjan një ekonomie që është krejtësisht e kontrolluar dhe e pronësuar nga shteti e ngjashme me atë të periudhës komuniste në vend. Kështu, ndërhyrja e shtetit në ekonomi, me disa specifikime sipas fushave, ka shumë të ngjarë të *perceptohet si ekonomi mikse* nga shumica e qytetarëve. Për pasojë ky shikohet si një opsion i dëshirueshëm.




Grafiku 9


Variacioni në varësi të të ardhurave dhe profilit ideologjik

Në lidhje me ndërhyrjen e shtetit në ekonomi, përgjigjet e të anketuarve nuk variuan as sipas të ardhurave dhe as sipas profilit ideologjik në mënyrë domethënëse, ndryshe nga çfarë mund të

pritej. Kjo është e qartë në grafikët 9.1 dhe 9.2.




Grafiku 9.1



Grafiku 9.2


Pohimi “shteti në Shqipëri duhet të rregullojë marrëdhëniet ekonomike, rregullat e përgjithshme të konkurrencës dhe tregtisë, etj” ishte përpiluar për të përkufizuar rolin rregullues të shtetit në ekonomi, domethënë një ekonomi mikse. Ndërkohë që besojmë se edhe pyetja paraardhëse u perceptua në të njëjtën kornizë konceptuale të ekonomisë mikse, pyetja aktuale duket më e preferuara për të anketuarit. Kështu, 84 përqind e të intervistuarve u përgjigjën se janë dakord me pohimin dhe vetëm 16 përqind besojnë të kundërtën.



Grafiku 10


Variacioni në varësi të të ardhurave dhe profilit ideologjik

Ndërsa të anketuarit përgjigjen nëse “shteti në Shqipëri duhet të rregullojë marrëdhëniet ekonomike, rregullat e përgjithshme të konkurrencës dhe tregtisë, etj”, ose jo, vihet re një shkallë variacioni në lidhje me të ardhurat. Kështu, ndërkohë që 87 përqind e atyre që zgjodhën se i përkasin grupit të të ardhurave ‘0-30 mijë Lekë’ ranë dakord me pohimin, kjo përqindje bie gradualisht me rritjen e të ardhurave deri sa arrin në 76 përqind në rastin e atyre që kanë nivel të ardhurash ‘mbi 160 mijë Lekë’. Megjithatë, ky nuk është një variacion domethënës duke qenë se të anketuarit e të gjitha niveleve të të ardhurave në përgjithësi ranë dakord me pohimin.




Grafiku 10.1

Kur vijmë tek profili ideologjik, i njëjti modalitet si në pyetje të mëparshme vihet re: ndërkohë që variacioni relativisht i përmbush pritshmëritë kur lëvizim nga ‘e majta’ drejt ‘qendrës së djathtë’, trendi “prishet” kur arrihet tek grupi i ‘djathtë’ ku 81 përqind e të intervistuarve janë dakord me pohimin se “shteti në Shqipëri duhet të rregullojë marrëdhëniet ekonomike, rregullat e përgjithshme të konkurrencës dhe tregtisë, etj”.



Grafiku 10.2


Pohimi i fundit mbi ekonominë nga e njëjta kategori pyeste nëse “shteti në Shqipëri nuk duhet të ndërhyjë në ekonomi pasi ekonomia e tregut vetërregullohet”. Një shumicë e konsiderueshme të anketuarish (77 përqind) nuk ishte dakord me pohimin, ndërkohë që vetëm 23 përqind menduan të kundërtën. Përgjigja ndaj kësaj pyetje është konsistente me qëndrimet e të anketuarve në lidhje me dy pyetjet e mëparshme mbi nivelin e ndërhyrjes së shtetit në ekonomi.



Grafiku 11

Variacioni në varësi të të ardhurave dhe profilit ideologjik


Ndërkohë që nuk raportohet ndonjë variacion domethënës në varësi të të ardhurave në përgjigjet e të anketuarve ndaj pohimit se “shteti në Shqipëri nuk duhet të ndërhyjë në ekonomi pasi ekonomia e tregut vetërregullohet”, një trend më domethënës vërehet në lidhje me profilin ideologjik. Në të njëjtin trend si në pyetjet paraardhëse, është e dukshme nga grafiku 11.1 se ka një variacion në lidhje me profilin ideologjik kur lëvizet në spektrin politik nga grupi ‘i majtë’ tek grupi i ‘qendrës së djathtë’, por sërish trendi “prishet” kur vijmë tek qëndrimet disi të papritura të shumicës së grupit të ‘djathtë’ me 76 përqind të tyre që nuk bien dakord me pohimin. Grupi i ‘qendrës së djathtë’ është sërish më djathtist se të djathtët kur vijmë tek qëndrimet mbi ekonominë e tregut dhe rolin e shtetit në ekonomi.



Grafiku 11.1

Nëse shikohet panorama e përgjithshme e përgjigjeve ndaj katër pyetjeve të mësipërme është e dukshme që shumica e të anketuarve kanë tendencën të mbështesin një ekonomi mikse të një forme apo një tjetre ku shteti luan rol, pavarësisht opinioneve të ndryshme mbi shtrirjen e këtij roli. Për më tepër, përgjatë pyetjeve të mësipërme vërehet që nuk ka variacion në lidhje me të ardhurat ndërkohë që ka një variacion të dobët në lidhje me profilin ideologjik ku vihen re sidomos përgjigje ideologjike të papërpunueshme nga ata që vetidentifikohen si mbështetës të krahut të djathtë.

Një tjetër pyetje në këtë seksion lidhej me *vendimmarrjen* mbi menaxhimin dhe përcaktimin e prioriteteve në lidhje me *shërbimet publike*. Të pyetur se e kujt duhet të jetë përgjegjësia mbi vendimmarrjen në lidhje me menaxhimin dhe prioritetet e shërbimeve publike, më shumë se gjysma e të anketuarve (58 përqind) u përgjigj që vendime të tilla duhet të merren “nga ekspertët dhe politikbërësit në bashkëpunim me publikun e gjerë apo grupet komunitare, të cilat përfitojnë dhe kontribuojnë për këto shërbime”. Nga pjesa e mbetur e të anketuarve 1/4 u përgjigj që “komuniteti dhe publiku në përgjithësi duhet të jenë shumë më të përfshirë në formësimin e këtyre shërbimeve duke u treguar prioritetet politikë-bërësve” dhe pjesa e mbetur prej 18 përqind mendojnë se këto vendime duhej t’u besoheshin ekspertëve të cilët kanë më shumë njohuri mbi këto çështje.




Grafiku 12

Variacioni në varësi të të ardhurave dhe profilit ideologjik

Është interesante të shikohet se ka një variacion të konsiderueshëm në varësi të të ardhurat kur të anketuarit përgjigjen në lidhje me aktorët që duhet të marrin vendime mbi shërbimet publike. Kështu,

duket se sa më të larta të ardhurat aq më shumë të anketuarit priren të përgjigjen se vendimet mbi shërbimet publike duhet të merren nga “ekspertët dhe politikë-bërësit në bashkëpunim me publikun e gjerë apo grupet komunitare, të cilat përfitojnë dhe kontribuojnë për këto shërbime”. Pra, siç mund të shihet nga grafiku 12.1, 51 përqind e atyre që i përkasin nivelit të të ardhurave ‘0-30 mijë Lekë’ zgjedhin këtë option kundrejt 80 përqind të atyre që i përkasin nivelit të të ardhurave ‘mbi 160 mijë Lekë’. Sigurisht, tendenca e kundërt është e pranishme për dy optionet e tjera të vendimmarrjes ekskluzive nga grupet komunitare apo ekspertët — ku me rritjen e të ardhurave, qytetarët janë më pak të prirur të zgjedhin këto opsione.




Grafiku 12.1

Pasi u përgjigjën pyetjes së mësipërme mbi ndarjen e përgjegjësiave midis zyrtarëve publik dhe komunitetit në lidhje me vendimmarrjen mbi shërbimet publike, qytetarët u pyetën në lidhje me angazhimin e tyre personal dhe *shkallën e ndikimit që ata kanë mbi vendimmarrjen në nivel lokal dhe qendror*. Ndërkohë që pyetjes së parë më shumë se gjysma e të anketuarve ju përgjigj që vendimet mbi shërbimet publike duhet të merren nga “ekspertët dhe politikë-bërësit në bashkëpunim me publikun e gjerë apo grupet komunitare, të cilat përfitojnë dhe

kontribuojnë për këto shërbime”, pyetjes mbi ndikimin personale një sasi e ngjashme të intervistuarish iu përgjigj që ata nuk kanë asnjë ndikim mbi vendimmarrjen në nivel lokal apo qendror.


Kështu, 47 përqind e të anketuarve u përgjigj se ata nuk kanë asnjë ndikim mbi formësimin e vendimeve mbi shërbimet publike në nivel lokal dhe 64 përqind u përgjigjën që nuk kanë asnjë ndikim mbi formësimin e vendimeve në nivel qendror. Nëse përgjigja ‘aspak influencë’ kombinohet me përgjigjen ‘pak influencë’, atëherë 80 përqind e të anketuarve u përgjigjën që ata kanë pak ose aspak influencë mbi vendimmarrjen në nivel lokal dhe 89 përqind u përgjigjën që ata kanë pak ose aspak ndikim në nivel qendror. Kur krahasohen përgjigjet e qytetarëve në lidhje me nivelin lokal dhe qendror, është e kuptueshme pse në nivel lokal qytetarët ndjejnë se kanë disi më tepër ndikim mbi vendimmarrjen (11 përqind më shumë qytetarë zgjedhin opsionet ‘disi’ ose ‘shumë’ ndikim mbi vendimmarrjen krahasuar me nivelin qendror).



Grafiku 13


Variacioni në varësi të të ardhurave dhe profilit ideologjik

Nga grafiku 13.1 është e dukshme që me rritjen e të ardhurave të anketuarit priren të mendojnë se ata kanë më shumë ndikim në vendimmarrje në nivel lokal. Kështu, kur lëvizim nga niveli i të ardhurave ‘0-30 mijë Lekë’ deri në nivelin ‘mbi 160 mijë Lekë’ përqindja e atyre që mendojnë se kanë ‘shumë’ ndikim rritet nga 2 përqind në 10 përqind. Ngjashëm, përqindja e atyre që mendojnë se kanë ‘disi’ ndikim në vendimmarrje në nivel lokal rritet nga 13 përqind në 22 përqind. Megjithatë, nuk mund të vërejmë një korrelacion të qartë midis të ardhurave dhe nivelit të perceptuar të ndikimit mbi vendimmarrjen në nivel lokal, duke qenë se edhe zgjedhja e alternativave ‘pak’ dhe ‘aspak’ ndikohet nga niveli i të ardhurave deri në njëfarë pike (për shembull duke lëvizur nga 55 përqind në 37 përqind për alternativën ‘aspak’), por prirja nuk është e plotë kur arrihet tek niveli i të ardhurave ‘mbi 160 mijë Lekë’.




Grafiku 13.1

Kur vijmë tek profili ideologjik i të anketuarve dhe përgjigjet e tyre ndaj së njëjtës pyetje, është e dukshme nga grafiku 13.2 që nuk ka variacion domethënës, edhe pse ata që e përcaktojnë veten si ‘qendër’ në spektrin politik, priren të mendojnë se kanë nivele më të larta ndikimi krahasuar me ata që vetë-identifikohen si të krahut të majtë apo të djathtë.



Grafiku 13.2


Në lidhje me nivelin e perceptuar të ndikimit të vendimmarrjes në nivel qendror, nga grafiku i mëposhtëm (13.3), është e dukshme se ka një variacion interesant në varësi të nivelit të të ardhurave. Kështu, kur kalojmë nga niveli i të ardhurave ‘0-30 mijë Lekë’ deri në nivelin ‘mbi 160 mijë Lekë’ përqindja e atyre që mendojnë se kanë ‘disi’ ndikim rritet nga 4 përqind në 14 përqind. Për më tepër, përqindja e atyre që mendojnë se nuk kanë ‘aspak’ ndikim gradualisht ulet nga 75 përqind e atyre që i përkasin nivelit të të ardhurave ‘0-30 mijë Lekë’ në 55 përqind e atyre që i përkasin nivelit ‘mbi 160 mijë Lekë’. Duke gjykuar nga këto përgjigje mund të themi se me rritjen e të ardhurave qytetarët priren të mendojnë se kanë një nivel më të lartë ndikimi mbi vendimmarrjen në nivel qendror.



Grafiku 13.3


Kur vijmë tek profili ideologjik, nga grafiku i mëposhtëm është e dukshme se nuk ka variacion domethënës. Përsëri, përgjigja ‘aspak’

ndikim duket më pak popullore ndër ata që identifikohen si të ‘qendrës’, krahasuar me ekstremet e së majtës dhe së djathtës (me 59 përqind, 57 përqind dhe 62 përqind, kundrejt 68 përqind dhe 64 përqind).



Grafiku 13.4

Përpara se të kalohej tek nënkapitulli mbi besimin, qytetarëve iu paraqit një pyetje e përgjithshme mbi *kapacitetin e shtetit në Shqipëri, respektimin e të drejtave të njeriut, aftësinë e shtetit për të funksionuar normalisht dhe për të ofruar shërbime*. Nga grafiku i mëposhtëm është e dukshme që të anketuarit ishin pothuajse të ndarë në mënyrë të barabartë në masën e të rënit dakord ose jo me pohimet. Është e rëndësishme për qëllimin e përgjithshëm të këtij sondazhi të vihet re se një mase më e madhe të intervistuarish nuk ranë dakord me pohimin se “shteti shqiptar iu ofron qytetarëve të vet të mirat publike bazë”, me 57 përqind e tyre që u përgjigjën se bien dakord ‘pak’ ose ‘aspak’ me këtë pohim. Në anën tjetër, të anketuarit ranë dakord më së shumti me pohimin që “shteti shqiptar është prezent në të gjithë territorin shqiptar”, ku 53 përqind u përgjigjën se bien ‘plotësisht’ ose ‘pjesërisht’ dakord me pohimin.



Grafiku 14


Nënkapitulli II: NIVELI I BESIMIT

Para se të shkojmë më thellë në çështjet e përmasave të shtetit, dialogut kolektiv, shërbimeve publike dhe mbrojtjes sociale, ky nënkapitull përpaket të identifikojë nivelin e besimit të shqiptarëve tek disa institucione të rëndësishme. Pavarësisht faktit që këto pyetje zakonisht kanë për qëllim të masin besimin, sikurse mund të shihet në grafik, institucionet janë renditur duke marrë parasysh *nivelin e mosbesimit* si vlerë renditëse parësore (vini re zonën blu në grafikun 15), për shkak të vlerave interesante krahasuese që përfaqëson niveli i mosbesimit duke qenë gjithashtu mjaft domethënës. Megjithatë vlerat e besimit janë shënuar, ato nuk kanë shërbyer si vlera renditëse në grafik, por do të jenë njësoj të rëndësishme gjatë analizës.

Duke parë vetëm nivelin e mosbesimit tek grafiku 15 – ata që kanë zgjedhur alternativën ‘aspak’ për një institucion specifik – institucionet që rezultojnë më mirë në shkallën e mosbesimit janë institucionet e arsimit publik – me vetëm 10 përqind të të anketuarve që kanë zgjedhur ‘aspak’ si përgjigje – ndjekur nga spitalet private me 12 përqind dhe policia, media dhe qeveria me 13 përqind secili. Në ekstremin tjetër, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), opozita dhe gjykatat rezultojnë secili me nivele të larta mosbesimi (30 përqind, 34 përqind dhe 35 përqind përkatësisht), ndërkohë që partitë politike janë më të mosbesuarat me 45 përqind të të anketuarve që nuk kanë aspak besim në to.

Nëse përgjigja ‘aspak’ bashkohet me përgjigjen ‘pak’ dhe konsiderohet si tregues i niveleve të ulëta të besimit, atëherë institucioneve që u përmendën më sipër, me nivele të larta mosbesimi, u shtohet edhe një tjetër: spitalet publike. Ndaj, në shkallën e mosbesimit ‘pak-aspak’, partitë politike mbeten sërisht vlera të veçuara me 80 përqind të të anketuarve që tregojnë pak ose aspak besim në to dhe gjykatat, opozita, KQZ dhe spitalet publike që shënojnë ndërmjet 69 përqind dhe 59 përqind mosbesim.


Nëse i kthehemi niveleve të besimit dhe shohim përqindjen e besimit të përcaktuar nga përgjigja ‘shumë’, spitalet private shënojnë vlera të larta me 23 përqind të të anketuarve që kanë ‘shumë’ besim tek këto institucione. Në terma të besimit, spitalet private ndiqen nga kryeministri me 20 përqind të të anketuarve që kanë shumë besim, media me 16 përqind dhe ushtria me 15 përqind. Nëse kombinojmë përgjigjet ‘shumë’ dhe ‘disi’, institucionet më të besuara janë spitalet private me 65 përqind dhe institucionet e arsimit publik me 63 përqind të të anketuarve që kanë ‘disi’ ose ‘shumë’ besim në to.



Grafiku 15

Nëse niveli aktual i (mos)besimit krahasohet me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duket se njerëzit kanë shprehur frustrim dhe mosbesim kundrejt institucioneve publike në periudhën parazgjedhore (shiko

grafikun 16). Duhet të vihet në dukje se sondazhi i vitit të kaluar pati një tjetër fokus, ndaj pyetja adresonte më pak institucione, ndërkohë që pyetja e vitit 2014 ka për qëllim zgjerimin e fokusit duke shtuar disa ofrues shërbimesh që do të jenë të rëndësishëm në pyetjet në vijim. Në vitin 2013, gjykatat dhe kryeministri patën nivele të ulëta besimi – ndaj edhe nivele të larta mosbesimi – me 45 përqind të të anketuarve që zgjedhën përgjigjen ‘aspak’, ndërkohë që media ishte institucioni më i besuar me 17 përqind të anketuarve që tregonin ‘shumë’ besim. Media rezultoi një prej institucioneve më të besuara në sondazhe. Në një sondazh të vitit 2011¹⁹ mbi rininë në Shqipëri, institucioni më i besuar ndër to ishte pikërisht media.


Grafiku 16²⁰

19. Arbjan Mazniku dhe Geron Kamberi, Stili i jetesës: Demokracia dhe qeverisja, në *Rinia Shqiptare 2011: Mes besimit për të ardhmen dhe dyshimit për të tashmen!*, Friedrich Ebert Stiftung. (Tiranë, 2001).f. 199.

20. Përgjigjet nga sondazhi *Gjendja e demokracisë shqiptare në prag të zgjedhjeve të përgjithshme 2013*.


Sikurse është e dukshme nga sondazhi i vitit 2013 dhe 2014, gjykatat janë disa nga institucionet më pak të besuara në vend. Në mënyrë që të kemi një panoramë më të detajuar rreth perceptimeve të qytetarëve mbi funksionimin e sistemit gjyqësor në Shqipëri, kjo pyetje e fundit e seksionit u kërkoi të anketuarve të binin dakord ose jo me disa deklaratata mbi sistemin gjyqësor. Është e qartë nga grafiku 17 se pjesa më e madhe e të anketuarve – më tepër se 60 përqind në çdo deklaratë – treguan nivel shumë të ulët besimi kundrejt sistemit gjyqësor në Shqipëri.

Në mënyrë më specifike, 76 përqind e të anketuarve nuk binin dakord me deklaratën se “sistemi gjyqësor në Shqipëri jep vendime të drejta”. Për më tepër, mbi 60 përqind e të anketuarve binin dakord me deklaratat se “qytetarët duhet të kenë lidhje politike në mënyrë që të kenë gjykim të drejtë” dhe “qytetarët duhet të kenë lidhje personale që të kenë gjykim të drejtë” dhe “qytetarët duhet të paguajnë ryshfete/të korruptojnë gjykatës/prokurorë në mënyrë që të kenë gjykim të drejtë”. Kështu, shumica e të anketuarve beson se sistemi i drejtësisë nuk jep vendime të drejta dhe se në mënyrë që të marrësh një gjykim të drejtë duhet të kesh lidhje politike dhe/ose personale dhe/ose të përdoret një formë korrupsioni kundrejt aktorëve kryesorë vendimmarrës.



Grafiku 17

Më poshtë janë përgjigjet për të njëjtën pyetje nga sondazhi i vitit 2013 që duken pothuajse identike me panoramën aktuale. Duket sikur nivelet aktuale të besimit janë pak më të larta, 3-6 përqind, krahasuar me vitin 2013, veçanërisht në lidhje me deklaratën e fundit mbi ryshfetet ku në vitin 2013 75 përqind e të anketuarve u përgjigjën se “në mënyrë që të kenë drejtësi, qytetarët duhet të paguajnë ryshfete”, ndërkohë që në 2014-ën, 68 përqind ishin dakord me këtë deklaratë.




Grafiku 18²¹

21. Përgjigjet nga sondazhi *Gjendja e demokracisë shqiptare në prag të zgjedhjeve të përgjithshme 2013*.

Nënkapitulli III: KONTRATA KOLEKTIVE DHE DIALOGU SOCIAL

Me fundin e komunizmit në Shqipëri – sikurse në vendet e tjera post-komuniste me përjashtim të disa vendeve si për shembull Sllovenia ku sindikatat ishin aktive – nuk pati një komunitet punëtorësh në terma kolektivë dhe sindikatat u kthyen në organizata formale pa legjitimitet real ndërmjet punëtorëve apo pushtet për të ndikuar vendimmarrjen në favor të të drejtave të punëtorëve. Për rrjedhojë, *dialogu social dhe negociatat për interesa kolektive*, si koncept dhe fenomen nuk janë praktika të zakonshme në Shqipëri.


Megjithatë, kur njerëzit u pyetën se kush duhet të jetë përgjegjës për të marrë vendime të rëndësishme mbi pagat, orët e punës dhe të drejtat e punëtorëve në Shqipëri, një shumicë e konsiderueshme e të anketuarve (61 përqind) u përgjigjën se “qeveria dhe politikë-bërësit në bashkëpunim me sindikatat e punëtorëve” duhet të jenë përgjegjëse për këtë. Për më tepër, 1/5 e të anketuarve u përgjigjën se këto vendime duhet të diskutohen dhe të vendosen “kryesisht nga sindikatat e punëtorëve” ndërkohë që qeveria dhe politikë-bërësit janë pika e fundit e procesit ose hallka e fundit. Vetëm 12 përqind u përgjigjën se këto vendime duhet të diskutohen dhe merren “vetëm nga institucionet publike, qeveria dhe politikë-bërësit”. Nga këto përgjigje është e dukshme se shumica e qytetarëve besojnë se sindikatat duhet të kenë rol aktiv në marrjen e vendimeve që lidhen me punëtorët.



Grafiku 19


Variacioni në varësi të të ardhurave dhe profilit ideologjik

Nga grafiku 19.1 është e dukshme se ka një shkallë variacioni në varësi të të ardhurave në lidhje me aktorët përgjegjës që duhet të marrin vendime të rëndësishme mbi pagat, orët e punës dhe të drejtat e punëtorëve në Shqipëri. Ndaj, kur lëvizim nga ‘0-30 mijë Lekë’ në ‘mbi 160 mijë Lekë’, të anketuarit priren të favorizojnë më tepër një model vendimmarrjeje bashkëpunues (me 69 përqind krahasuar me 55 përqind) ku si qeveria ashtu edhe sindikatat marrin pjesë, ndërkohë që ekskluziviteti i njërës apo i tjetrës është më pak i dëshirueshëm. Kjo prirje është vënë re edhe më parë nga pyetja mbi vendimmarrjen rreth menaxhimit të shërbimeve publike, ku sa më të larta të ardhurat aq më të prirur janë të anketuarit të mbështesin një model bashkëpunues të vendimmarrjes.



Grafiku 19.1

Nga grafiku 19.2 është e qartë se nuk ka variacion sipas profilit ideologjik, megjithëse ata që e vendosin veten në qendër të spektrit priren të jenë më mbështetës të modelit bashkëpunues të vendimmarrjes krahasuar me pjesën tjetër të spektrit politik.




Grafiku 19.2

Ndërkohë që pyetjes së mëparshme, shumica e të anketuarve (61 përqind) i është përgjigjur se vendimet në lidhje me çështjet e punëtorëve duhet të merren nga politikë-bërësit në bashkëpunim me sindikatat, e dhëna e parë nga grafiku i kësaj pyetjeje është se të anketuarit ndjenin se nuk kishin mjaftueshëm informacion në lidhje me *situatën aktuale të sindikatave* në Shqipëri. Ndaj, dy pohimeve të rëndësishme mbi aktivitetin e sindikatave – sindikatat janë “ekzistuese por jo efektive në mbështetjen e të drejtave të punëtorëve” dhe ato “nuk janë të pavarura nga partitë politike ose grupe të tjera” – shumica e të anketuarve nuk ishin në gjendje t’u jepnin një përgjigje mbi nivelin e pajtueshmërisë me to. Për më tepër, 86 përqind e të anketuarve nuk ishin në gjendje të binin dakord ose jo me deklaratën se sindikatat sot janë “aktive dhe efektive në mbështetjen e të drejtave të punëtorëve”.

Përveç mungesës së informacionit mbi çështje specifike që lidhen me aktivitetin aktual të sindikatave, për ata që ranë dakord ose jo me deklaratën, më tepër se gjysma mendojnë se sindikatat janë “ekzistuese por jo efektive në mbështetjen e të drejtave të punëtorëve” dhe 33 përqind ranë dakord se këto sindikata “nuk janë të pavarura nga partitë

politike ose grupe të tjera”. Është interesante të vihet re se më tepër se gjysma e të anketuarve (56 përqind) u përgjigjën se nuk binin dakord me deklaratën se sindikatat janë “jo ekzistuese pas rënies së komunizmit”, ndërkohë që vetëm 31 përqind ranë dakord me këtë.



Grafiku 20

Duke parë panoramën e përgjithshme të paraqitur nga përgjigjet e të anketuarve ndaj pohimeve të mësipërme, duket sikur pjesa më e madhe e qytetarëve janë të ndërgjegjshëm për ekzistencën e sindikatave por nuk kanë informacion për aktivitetin e tyre aktual në Shqipëri.


Nënkapitulli IV: SHËRBIMET PUBLIKE DHE ROLI I SHTETIT

Ky nënkapitull mbi shërbimet publike dhe përmasat/rolin e shtetit përfaqëson një prej seksioneve kryesore të sondazhit, ku janë ngritur disa prej pyetjeve më thelbësore. Ky grup pyetjesh ka për qëllim marrjen e opinioneve të të anketuarve mbi çështjet thelbësore, kryesisht të lidhura me pyetjet ‘kush’ dhe ‘si’. Ky hulumtim mbi aktorët, rolet dhe modalitetet është thelbësor për njohjen e qëndrimeve të qytetarëve mbi mirëqenien, rolin e shtetit dhe përmasat e tij dhe veçanërisht vlerat që gjenden në bazë të strukturës sociale në Shqipëri. Nëse ajo çfarë qëndron në qendër të përgjigjeve të qytetarëve është një nevojë për më shumë efikasitet, një kërkesë për më shumë solidaritet social, një kërkesë për më shumë hapësirë për iniciativa personale apo më tepër trashëgimia e së kaluarës, kjo është diçka që kërkon më shumë punë kërkimore për t’u përcaktuar. Megjithatë, pyetjet e kësaj rubrike japin disa detaje të rëndësishme mbi qëndrimet e tanishme të qytetarëve shqiptarë në raport me shtetin dhe shoqërinë, si dhe në lidhje me marrëdhëniet shtet-shoqëri.

Përveç nevojës së përgjithshme për të përcaktuar vlerat, mendimet dhe qëndrimet e qytetarëve shqiptarë në lidhje me këto çështje të rëndësishme, ky kapitull ka një profil shumë bashkëkohor në matjen e qëndrimeve të qytetarëve mbi një temë kryesore të debatit publik shqiptar gjatë këtyre viteve: *ofrimi i shërbimeve publike nga shteti kundrejt ofrimit të shërbimeve publike nga entitete private*. Rrjedhimisht kjo pjesë ofron një skicë të qëndrimeve të qytetarëve shqiptarë mbi temën e mësipërme në lidhje me ofrimin e disa prej shërbimeve publike bazë.

Kur u pyetën se kush duhet të jetë *ofruesi kryesor i disa prej shërbimeve kryesore publike*, të anketuarit u treguan relativisht

të qëndrueshëm në opinionin e tyre se shteti duhet të jetë ofruesi kryesor. Megjithatë, brenda kësaj prirje ka disa variacione që duhet të merren në konsideratë. Në njërin skaj të grafikut qëndrojnë siguria publike dhe drejtësia të cilat janë përzgjedhur nga qytetarët si fusha ekskluzive të ofruara nga shteti me 91 përqind të të anketuarve që cilësojnë shtetin si ofrues kryesor për secilin rast. Në skajin tjetër të grafikut qëndrojnë shërbimet postare, strehimi dhe punësimi, ku shteti ende shihet si ofrues kryesor, por me një përqindje më të ulët, 66-69 përqind, krahasuar me shërbimet e tjera. është e rëndësishme të theksohet se strehimi në aspektin e ofrimit të shërbimeve konsiderohet nga 8 përqind e të anketuarve si çështje që i përket familjes dhe subjekteve të tjera të ngjashme, edhe pse kjo është një përqindje shumë e ulët në krahasim me ata që e cilësojnë shtetin si aktorin kryesor përgjegjës për ofrimin e strehimit.




Grafiku 21

Përderisa disa shërbime janë shumë të qenësishme dhe të rëndësishme për të kuptuar opinionet dhe këndvështrimet e qytetarëve mbi çështjet e ofrimit të shërbimeve, tre pyetjet e mëposhtme përqendrohen veçanërisht në arsim, kujdesin shëndetësor dhe pensionet. Pyetjet

janë formuluar qëllimisht në trajtën ‘*duhet të jetë*’ në mënyrë që të anketuarit të tregojnë natyrën e preferuar të shërbimit, pavarësisht statusit të tanishëm të ofrimit të këtij shërbimi në aspektet e ofruesit apo menaxhimit. Për më tepër, në lidhje me vlerat, një formulim i tillë i fton të anketuarit të konsiderojnë dimensionin normativ të çështjes.


Kështu, për sa i përket *arsimit*, shumica e të anketuarve (44 përqind) janë përgjigjur se arsimi në Shqipëri duhet të jetë “publik dhe i financuar nga taksat publike”. Një përqindje e ngjashme e përgjigjeve (40 përqind) mendon se arsimi në Shqipëri duhet të jetë “publik dhe i financuar pjesërisht nga taksat dhe pjesërisht nga tarifat e përdoruesve të shërbimit”. Këto dy opsione, të cilët mbështesin profilin publik të arsimit në Shqipëri, përfaqësojnë variantet më të përzgjedhura ndërsa dy opsionet e tjera: arsimi duhet “të financohet nga fonde publike dhe të menaxhohet nga organizata private” dhe të jetë “privat dhe i financuar nga pagesat e çdo qytetari që e përdor shërbimin” u përzgjedhën nga rreth 8 përqind e të anketuarve secili.



Grafiku 22

Variacioni në varësi të të ardhurave dhe profilit ideologjik


Kur bëhet fjalë për çështje financiare të lidhura me arsimin në Shqipëri, ka një variacion të qartë për sa i përket të ardhurave (Grafiku 22.1). Kështu, sa më të larta të jenë të ardhurat, aq më shumë të anketuarit do të kenë tendencën të mbështesin idenë se arsimi në Shqipëri duhet të jetë “publik dhe i financuar pjesërisht nga taksat dhe pjesërisht nga tarifat e përdoruesve të shërbimit” (me një variacion nga 39 përqind në 47 përqind me rritjen e të ardhurave), ndërsa me shtimin e të ardhurave, aq më pak të anketuarit kanë tendencën të mbështesin opsionin se “arsimi në Shqipëri duhet të jetë publik dhe i financuar nga taksat publike” (me një variacion nga 50 përqind në 29 përqind me rritjen e të ardhurave). Për më tepër, me rritjen e të ardhurave, të anketuarit janë treguar përkrahës të qëndrimit se arsimi në Shqipëri duhet të jetë “i financuar nga taksat publike, por i menaxhuar nga organizata private” (me një variacion nga 5% në 14%). Përkrahës të kësaj ideje nuk ishte më e përkrahura në terma të përgjithshëm.



Grafiku 22.1


Nga grafiku 22.2 është e dukshme se nuk ka variacion sipas profilit ideologjik në lidhje me financimin dhe menaxhimin e arsimit në Shqipëri. Kështu, të anketuarit përkrahës të së majtës,

qendrës së majtë dhe qendrës së djathtës, kryesisht preferojnë një arsim që është “publik dhe i financuar nga taksat publike” (përkatesisht 48 përqind, 48 përqind dhe 47 përqind e tyre) ndërsa të anketuarit përkrahës të qendrës dhe krahut të djathtë preferojnë një arsim që është “publik dhe financohet pjesërisht nga taksat dhe pjesërisht nga tarifat e përdoruesve” (përkatesisht 48 përqind dhe 47 përqind).



Grafiku 22.2


Kur e njëjta pyetje është bërë në lidhje me *kujdesin shëndetësor* në Shqipëri, preferencat e të anketuarve janë pothuajse identike me pyetjen e mëparshme. Në këtë kontekst gjysma e të anketuarve u përgjigjën se kujdesi shëndetësor duhet të jetë “publik dhe i financuar nga taksat e përgjithshme” dhe 32 përqind u përgjigjën se ai duhet të jetë “publik dhe i financuar pjesërisht nga taksat dhe pjesërisht nga tarifat e përdoruesit”. Kështu, më shumë se 80 përqind e të anketuarve zgjodhën dy mundësitë njëjta si për arsimin ashtu dhe për kujdesin shëndetësor. Vetëm 11 përqind e të anketuarve u përgjigjën se kujdesi shëndetësor duhet të jetë “i financuar nga taksat publike, por i menaxhuar nga organizatat private”.



Grafiku 23


Variacioni në varësi të të ardhurave dhe profilit ideologjik

Kur është fjala për financimin dhe menaxhimin e kujdesit shëndetësor në Shqipëri, vihet re një variacion i kufizuar në varësi të të ardhurave të të anketuarve. Kështu, kur lëviz nga ‘0-30 mijë Lekë’ tek ‘100-160 mijë Lekë’ ulet mbështetja për një kujdes shëndetësor që është “publik dhe financohet nga taksat publike” (nga 55 për qind në 43 për qind me rritjen e të ardhurave) për t’u rritur përsëri (57 për qind) për të anketuarit me nivel të ardhurash mbi ‘160 mijë Lekë’. Prirja e kundërt ndodh me qëndrimin se kujdesi shëndetësor në Shqipëri duhet të jetë “publik dhe të financohet pjesërisht nga taksat dhe pjesërisht nga tarifat e përdoruesve”.




Grafiku 23.1

Nga grafiku 23.2 shohim një prirje të konstatuar më parë në lidhje me profilin ideologjik: e majta ekstreme dhe e djathta kanë pikëpamje të ngjashme, por të ndryshme nga pjesa qendrore e spektrit politik. Kështu, në lidhje me kujdesin shëndetësor, të anketuarit që i përkasin krahut të majtë dhe të djathtë – përkatësisht me 57 dhe 51 përqind – kryesisht mbështesin një kujdes shëndetësor që është “publik dhe i financuar nga taksat e publike”. Nga ana tjetër, përkrahësit e qendrës së majtë, qendrës dhe qendrës së djathtë kanë tendencë të jenë më të balancuar midis një kujdesi shëndetësor që është “publik dhe i financuar nga taksat publike” dhe një kujdesi shëndetësor që është “publik dhe i financuar pjesërisht nga taksat dhe pjesërisht nga tarifat e përdoruesve”.



Grafiku 23.2


Në lidhje me *pensionet*, vetëm 1/3 e të anketuarve mendoi se gjendja e tanishme, ku pensionet janë të menaxhuara publikisht dhe të financuara nga kontributet sociale, ishte mënyra e duhur se si duhet të organizohen pensionet në Shqipëri. Përkundër kësaj, pothuajse gjysma (49 përqind) e të anketuarve deklaruan se pensionet “duhet të menaxhohen nga autoritetet publike dhe të financohen nga kontributet sociale, por t’u jepet e drejta e zgjedhjes atyre që duan”. Është interesante të shohësh se 9 përqind e të anketuarve ka përzgjedhur variantin ende jo popullor në Shqipëri, atë të skemave private të pensioneve.



Grafiku 24

Variacioni në varësi të të ardhurave dhe profilit ideologjik


Nga grafiku 24.1 është e dukshme se ka një ndryshim të konsiderueshëm në varësi të të ardhurave, kur është fjala për mënyrën se si pensionet në Shqipëri duhet të financohen dhe menaxhohen. Kështu, me rritjen e të ardhurave, të anketuarit kanë prirjen të mbështesin qëndrimin se pensionet në Shqipëri duhet “të menaxhohen nga sektori publik dhe të financohen nga kontributet sociale, por t’u jepet e drejta e zgjedhjes atyre që duan një skemë



Grafiku 24.1

private”si dhe kanë prirje të mos mbështesin pohimin që pensionet duhet të “menaxhohen nga sektori publik dhe të financohen nga kontributet sociale, siç janë aktualisht”. Në të njëjtën mënyrë, me rritjen e të ardhurave,të anketuarit gjithashtu priren të zgjedhin pohimin që pensionet në Shqipëri duhet “të funksionojë plotësisht sipas skema dhe kontribute private”.

Nga grafiku 24.2, mund të shohim se nuk ka asnjë variacion domethënës në varësi të profilin ideologjik. Megjithatë, ajo që mund të vihet re është se ndërkohë që të gjithë të anketuarit e spektrit politik priren të jenë më mbështetës të një skeme të përzier, ku e drejta për të zgjedhur është gjithashtu e pranishme, të anketuarit e majtë janë më ideologjik në përgjigjen e tyre me 39 përqind që mbështesin skemat e pensioneve që janë të “menaxhuara publikisht dhe të financuara nga kontributet sociale, siç janë aktualisht”.




Grafiku 24.2

Kur është fjala për nivelin e kënaqësisë së qytetarëve me standardet e atyre shërbimeve publike që ofrohen nga shteti në Shqipëri, ka një tendencë të ngjashme me pyetjet e mëparshme. Ngjashëm me pyetjet mbi nivelin e besimit, shërbimet publike në grafikun 25 janë listuar si pas


nivelit të raportuar të pakënaqësisë se sa sipas nivelit të kënaqësisë. Nga grafiku 25 është e dukshme se shërbimet e vlerësuara më pak negativisht janë ato të energjisë elektrike, arsimit dhe furnizimi me ujë të pijshëm, me përqindjen më të vogël të njerëzve që zgjedhin ‘të pakënaqur’, si përgjigje (përkatësisht 13 përqind, 14 përqind dhe 18 përqind). Nga ana tjetër, të anketuarit kishin nivelin më të lartë të pakënaqësisë në lidhje me menaxhimin e mbetjeve, nxitjen e punësimit dhe mbrojtjen e konsumatorit, me përkatësisht 56 përqind, 52 përqind dhe 44 përqind të qytetarëve që zgjedhën përgjigjen ‘shumë të pakënaqur’.

Nëse dy opsionet e pakënaqësisë ‘shumë të pakënaqur’ dhe ‘jo shumë të kënaqur’ kombinohen, atëherë shërbimet publike më të keq-vlerësuara nga qytetarët janë ato të shëndetësisë me 87 përqind, drejtësia dhe/ose çështjet e lidhura me drejtësinë me 85 përqind dhe promovimi i punësimit me 85 përqind. Është e rëndësishme të vërehet se përveç energjisë elektrike, për të gjitha shërbimet e tjera më shumë se 50 përqind e qytetarëve të anketuar janë ‘të pakënaqur’ ose ‘jo shumë të kënaqur’ me to.



Grafiku 25

Në mënyrë që të merrnim të dhëna të tjera mbi opinionet e qytetarëve mbi disa nga shërbimet publike më të rëndësishme, ata u pyetën mbi *cilësinë e shërbimeve të ofruara nga institucionet publike dhe private* në Shqipëri. Përgjigjet e të anketuarve për këto pyetje përputheshin me pyetjet e mëparshme. Kështu, kur u pyetën se cili ofron cilësi më të mirë të shërbimeve, siguria publike dhe arsimi ishin në krye të listës dhe këtu institucionet publike konsiderohen si ofrues më të mirë të shërbimeve me përkatësisht 65 përqind dhe 63 përqind të përgjigjeve që u referohen institucioneve publike. Nga ana tjetër, shëndetësia dhe promovimi i punësimit konsiderohen se ofrohen më mirë nga sektori privat, me përkatësisht 69 përqind dhe 52 përqind të përgjigjeve që zgjedhin sektorin privat. Këto përgjigje përputheshin veçanërisht me pyetjet e mëparshme mbi besimin, ku spitalet private dhe institucionet e edukimit publik rezultuan si institucionet më të besuara.



Grafiku 26

Një tendencë konstante që vihet re gjatë gjithë studimit dhe sidomos përgjatë këtij seksioni, është tendenca e të anketuarve për të zgjedhur shtetin, institucionet publike dhe financimin publik si mënyrat më të preferuara dhe të dëshirueshme për të ofruar shërbime publike (me shumë pak përjashtime të lidhura me kujdesin shëndetësor dhe


ndonjëherë strehimin, promovimin e punësimit, etj). Meqenëse shërbimet publike që ofrohen nga shteti janë të lidhura ngushtë me nivelin e taksave dhe kontributeve të qytetarëve, pyetja tjetër i pyeti qytetarët nëse ata bien dakord me një seri pohimesh në lidhje me taksimin.

Të anketuarit më së shumti ranë dakord – 70 përqind në të dy rastet - me qëndrimet se “unë do të isha i gatshëm për të kontribuar me mjete jofinanciare (vullnetare, shërbimet komunitare, etj)” dhe “kush fiton më shumë duhet të paguajë më shumë”. Të anketuarit ishin të ndarë pothuajse në mënyrë të barabartë në përgjigjet në lidhje me pohimin se “niveli i taksave duhet të rritet në qoftë se kjo do të sjellë shërbime më të mira”, me 51 përqind mospajtim dhe 49 përqind që ranë dakord. Të anketuarit më së shumtin nuk ranë dakord me pohimet se “niveli i taksave duhet të ulet pasi unë dua t’i siguroj vetë shërbimet për veten dhe familjen time” dhe “tatimet mbi të ardhurat duhet të ketë një normë fikse pavarësisht nga niveli i të ardhurave”, me 60 përqind mospajtim me deklaratën e parë dhe 62 përqind me të dytën.

Nga këto përgjigje është e dukshme se ndërsa të anketuarit janë të pavendosur nëse do të paguanin më shumë për shërbime më të mira, ata janë më të vendosur për mënyrën sesi mendojnë se duhet të paguhen shërbimet publike. Dy pohimet: “kush fiton më shumë duhet të paguajë më shumë” dhe “taksat mbi të ardhurat duhet të kenë një përqindje fikse, pavarësisht nivelit të të ardhurave”, janë konceptuar për të përshkruar përkatësisht taksën progresive dhe të sheshtë me fjalë të thjeshta.²² Në këtë kuadër, për sa i përket taksimit, duket se të anketuarit mbështesin taksimin progresiv krahasuar me atë të sheshtë. Nga përgjigjet e të anketuarve është e dukshme se

22. Taksa e sheshtë gjithashtu nënkupton se kush fiton më shumë duhet të paguajë më shumë, edhe kur norma e tatimit është fikse, por në rastin tonë vënia e këtij qëndrimi bashkë me atë që specifikisht përmend nivelet fikse, bëhet me qëllim që të dy qëndrimet të dallohen si të ndryshme.

qytetarët do të preferonin që pabarazitë sociale të reduktoheshin nga kontributet më të larta të atyre që fitojnë më shumë.




Grafiku 27

Variacioni në varësi të të ardhurave dhe profilit ideologjik

Cross-tabulimet e raportuara më poshtë në lidhje me grafikun 27 janë përzgjedhur në përputhje me variacionin që paraqesin në varësi të të ardhurave dhe/ose profilit ideologjik, ndërsa qëndrimet që nuk përmbanin asnjë variacion ose kur ky i fundit ishte i papërfillshëm, nuk u përfshinë.


Në lidhje me pohimin “kush fiton më shumë duhet të paguajë më shumë”, nga grafiku 27.1 mund të vërehet se ka variacion në varësi të nivelit të të ardhurave. Kështu, me rritjen e të ardhurave ka një rënie të nivelit të pajtimit me pohimin. Ndërsa 71 përqind e të anketuarve me të ardhura që variojnë nga ‘0-30 mijë Lekë’ pajtohen se “kush fiton më shumë duhet të paguajë më shumë”, 58 përqind e të anketuarve me të ardhura ‘mbi 160 mijë Lekë’, ranë dakord me këtë pohim. Niveli i pranimit nga pjesa tjetër e të anketuarve

varionte midis këtyre dy përqindjeve. Ky variacion i raportuar, plotëson pritshmëritë që sa më shumë njerëzit të fitojnë, aq më pak janë ata të gatshëm për të mbështetur një taksimin progresiv, edhe pse 58 përqind e mbështetjes nga të anketuarit me të ardhura mbi ‘160 mijë Lekë’, është ende një vlerë e lartë e mbështetjes për taksimin progresiv nga kjo pjesë e popullsisë.



Grafiku 27.1


Një variacion i rëndësishëm është i pranishëm edhe në varësi të profilit ideologjik të të anketuarve. Kështu, nga grafiku 27.2 është e qartë se kur lëvizet nga ana e majtë e spektrit politik në anën e djathtë bie niveli i pajtimit të të anketuarve me pohimin “kush fiton më shumë duhet të paguajë më shumë”. Kështu, pasi 82 përqind e të anketuarve të krahut të majtë pajtohen me deklaratën, 57 përqind e të anketuarve të krahut të djathtë bien dakord, ndërsa pjesa qendrore e spektrit politik gjendet diku midis këtyre vlerave. Ky variacion i raportuar përshtatet me pritshmërinë e përgjithshme në lidhje me profilin ideologjik, sipas të cilit sa më në të djathtë të spektrit politik të shkosh, aq më pak njerëz do e mbështesin një taksimit progresiv. Megjithatë, 57 përqind mbështetje nga ana e të anketuarve të krahut



Grafiku 27.2


të djathtë për një qëndrim të tillë është prapë një përqindje shumë e lartë për mbështetësit e një ideologjie të djathtë.

Kur është fjala për nivelin e taksimit, përsëri ka variacion në varësi të nivelit të të ardhurave. Nga grafiku 27.3 është e dukshme se me rritjen e të ardhurave, rritet dhe niveli i mbështetjes për qëndrimin se “niveli i taksave duhet të rritet në qoftë se kjo do të sjellë në shërbime më të mira”. Kështu, ndërsa mbështetja për pohimin është 40 përqind për të anketuarit me të ardhura ‘0-30 mijë Lekë’, kjo mbështetje rritet gradualisht me rritjen e të ardhurave deri sa arrin 55 përqind për të anketuarit me ‘mbi 160 mijë Lekë’ të ardhura.




Grafiku 27.3

Në lidhje me të njëjtën pyetje dhe profilin ideologjik të të anketuarve, nga grafiku 27.4 duket sikur nuk ka ndonjë ndryshim në lidhje me profilin ideologjik, me përjashtim të të anketuarve të krahut të majtë, tek të cilët ky trend nuk vazhdon. Kështu, kur lëviz nga qendra e majtë në krahun e djathtë, përqindja e atyre që mbështesin deklaratën gradualisht bie nga 57 përqind në 44 përqind.




Grafiku 27.4

Kur vijmë tek taksimi i sheshtë, nuk ka ndonjë variacion të rëndësishëm në varësi të të ardhurave, ndërkohë që të gjitha nivelet e të ardhurave kryesisht nuk bien dakord me taksimin e sheshtë.



Grafiku 27.5

Kur është fjala për profilin ideologjik të të anketuarve në lidhje me të njëjtën pyetje ka disi variacion të rëndësishëm. Kështu, kur ne shkojmë nga krahu i majtë i spektrit politik në të djathtin, niveli i mbështetjes për taksën e sheshtë gradualisht rritet, ndërkohë që i gjithë spektri politik është kryesisht kundër faktit se tatimet duhet të kenë një normë fikse. Kështu, ndërkohë që 30 përqind e të anketuarve të krahut të majtë mbështesin taksimin e sheshtë, 47 përqind e të anketuarve të krahut të djathtë e përkrahin atë. Edhe pse ky variacion dhe tendencë mbështetjeje pritej, mbështetja e përgjithshme e krahut të djathtë për taksën e sheshtë (47 përqind) është më e ulët nga sa mund të pritej.




Grafiku 27.6

E fundit, por jo më pak e rëndësishmja, një pyetje që do të japë disa të dhëna të mëtejshme në lidhje me rolin e preferuar të shtetit nga ana e qytetarëve shqiptarë lidhet me *privatizimin dhe ndërmarrjet*

shtetërore. Nga grafiku më poshtë, është e dukshme se qytetarët kanë rënë më së shumti dakord me dy qëndrimet: “shteti shqiptar duhet të kontrakttojë kompani private menaxhimi, pa hequr dorë nga pronësia e shtetit mbi ndërmarrjet shtetërore” dhe se “privatizimi i bën ndërmarrjet shtetërore më efektive në ofrimin e shërbimeve”, me respektivisht 70 përqind dhe 66 përqind. Në anën tjetër, të anketuarit nuk ishin dakord në një shkallë të ngjashme — përkatësisht 72 dhe 65 përqind — me pohimet: “të gjitha ndërmarrjet shtetërore në Shqipëri duhet të privatizohen” dhe “asnjë proces privatizimi i çfarëdo lloji nuk duhet të aplikohet në lidhje me menaxhimin apo pronësinë e ndërmarrjeve shtetërore”.


Ndërsa shumica e të anketuarve është e mendimit se privatizimi i bën ndërmarrjet shtetërore më efektive në ofrimin e shërbimeve, një pjesë edhe më e madhe e tyre mendon se në Shqipëri nuk duhen privatizuar të gjitha ndërmarrjet shtetërore. Duket sikur shqiptarët kanë zgjedhur mesin e artë, i cili është aplikimi i një modeli ku shteti vazhdon të jetë pronari ndërmarrjeve të rëndësishme, ndërsa kompanitë private kontrktohen vetëm për pjesën e menaxhimit.



Grafiku 28


Variacioni në varësi të të ardhurave dhe profilit ideologjik

Ndërsa nuk po e raportojmë këtu grafikun e të ardhurave — pasi nuk ka asnjë variacion në varësi të të ardhurave në lidhje me faktin nëse shteti shqiptar duhet të kontraktojë ose jo kompani private menaxhuese, pa hequr dorë nga pronësia mbi ndërmarrjet shtetërore — vlen të përmendet që kemi të bëjmë me një situatë tjetër për sa i përket profilit ideologjik të të anketuarve. Edhe pse prirja nuk është e plotë kur është fjala për qëndrimet e të anketuarve të krahut të djathtë, vihet re një variacion kur lëvizim nga krahu i majtë drejt qendrës së djathtë. Kështu, ndërkohë që 72 përqind e të anketuarve të krahut të majtë pajtohen me faktin se shteti në Shqipëri duhet të kontraktojë kompani menaxhuese pa hequr dorë nga pronësia mbi ndërmarrjet shtetërore, kjo përqindje ulet në 55 përqind tek të anketuarit e qendrës së djathtë.




Grafiku 28.1

Në lidhje me pohimin se “privatizimi i bën ndërmarrjet shtetërore më efektive në ofrimin e shërbimeve”, nuk u konstatua ndonjë variacion në varësi të të ardhurave, por u has në varësi të profilit ideologjik. Megjithatë të anketuarit e krahut të djathtë gjenden ende jashtë kësaj tendence, konstatohet një rritje graduale e pajtueshmërisë me pohimin kur lëvizet nga krahu i majtë i spektrit drejt qendrës së djathtë (nga 59 përqind në 85 përqind).




Grafiku 28.2

Në lidhje me pohimin se “asnjë proces privatizimi i çfarëdo lloji nuk duhet të ndërmerret për menaxhimin apo pronësinë e ndërmarrjeve publike”, nuk u konstatua ndonjë variacion i qenësishme në aspektin e profilit ideologjik, por ka një variacion në lidhje me të ardhurat. Kështu, me rritjen e të ardhurave, të anketuarit kanë tendencën të bien më pak dakord me pohimin.



Grafiku 28.3

Në lidhje me qëndrimin se “të gjitha ndërmarrjet shtetërore në Shqipëri duhet të privatizohen”, vërehet një variacion i qenësishëm në varësi të profilit ideologjik. Kështu, duke lëvizur nga e majta në të djathtën e spektrit politik, niveli i pajtimit të të anketuarve me këtë qëndrim ka tendencë rritjeje. Kjo tendencë është në përgjithësi në përputhje me pritshmëritë.



Grafiku 28.4

Nënkapitulli V: SHANSET E BARABARTA DHE MBROJTJA SOCIALE


Pasi të anketuarit u ftuan për të dhëne një mendim në lidhje me shërbimet publike dhe ofrimin privat kundrejt atij publikë të tyre, ky seksion fokusohet në çështje shoqërore përmes matjes së opinionit qytetar në lidhje me mbrojtjen sociale dhe shanset e barabarta. Ky seksion është veçanërisht i lidhur me çështjet e solidaritetit shoqëror të cilat janë në themel të shteteve të mirëqenies dhe që për disa shkolla filozofike europiane solidariteti përfaqëson një nga elementët kryesorë të kohezionit social për shoqëritë moderne. Rrjedhimisht, seksioni merret me çështje të tilla si: shoqëria e drejtë, asistenca sociale, hendeku midis të varfërve dhe të pasurve, siguria e punës, politikat e rishpërndarjes, etj. Krahësuar me seksionet e mëparshme, ky seksion në mënyrë specifike qëmton *vlerat dhe parimet* që qëndrojnë në qendër të mendimeve dhe pikëpamjeve të qytetarëve.

Duke filluar nga një pyetje që përcakton bazat e kapitullit, u pyet sesi e perceptonin qytetarët *një shoqëri të drejtë*. Të anketuarit ishin të ndarë kryesisht në mes të dy pohimeve: që një shoqëri e drejtë është ajo ku “ai që paguan më shumë merr më shumë, por disa grupe të dobëta të shoqërisë duhet të ndihmohen nga shteti” dhe “askush nuk lihet pa shërbime publike bazë, pavarësisht aftësisë së tij për të kontribuar”, të cilat u miratuar nga përkatësisht 36 përqind e të anketuarve për secilin pohim. Një pjesë tjetër, rreth 1/5 e të anketuarve, është përgjigjur se në një shoqëri të drejtë “çdokush shpërblehet në pasuri, në përputhje me talentin dhe kontributin e dhënë”. Shumica e të anketuarve (72 përqind), në një mënyrë radikale apo të ekuilibruar, besojnë se në një shoqëri të drejtë duhet të ketë një shkallë të caktuar solidariteti për segmente të pa-avantazhuar të shoqërisë.



Grafiku 29


Duke vazhduar me një pyetje specifike mbi *asistencën e papunësisë* në Shqipëri, një shumicë e konsiderueshme e të anketuarve (83 përqind) u përgjigj se shuma aktuale e alokuar për çdo familje, ishte shumë e vogël. Dy opsionet e tjera, ku asistenca e papunësisë është e deklaruar si e lartë ose si e drejtë, morën një përqindje miratimi të papërfillshme, krahasuar me opsionin e mësipërm. Është thuajse e pamundur që 83 përqind e kampionit tonë të kenë marrë ndihmë financiare nëpërmjet kësaj skeme asistence, ndaj është e qartë që qytetarët e perceptojnë këtë asistencë si të pamjaftueshme, pavarësisht eksperiencës së tyre personale.



Grafiku 30

Grafiku 31 më poshtë pasqyron përgjigjet e të anketuarve mbi një listë pohimesh të lidhura me ato që shteti shqiptar duhet t’u ofrojë kategorive të ndryshme të qytetarëve në Shqipëri. Në të gjitha pohimet, shumica dërrmuese e të anketuarve bie dakord plotësisht me ato pohime të cilat përmbajnë një rol proaktiv të shtetit në ofrimin e ndihmës dhe mbrojtjes sociale për kategori të ndryshme shoqërore.


Megjithatë, ndërsa përqindjet e mospajtimit me pohimet janë të parëndësishme, niveli i pranimet të plotë dhe miratimit të pjesshëm është më interesant për t’u diskutuar. Pohimet që treguan një shkallë më të lartë të ‘miratimit të pjesshëm’ — megjithëse ende të ulët në krahasim me pranimin e plotë — ishin që shteti duhet të sigurojë “shërbime të mjaftueshme për kujdesin ndaj fëmijëve të prindërve që punojnë”, dhe se shteti duhet të sigurojnë “një vend pune për të gjithë ata që e duan një të tillë”, ku përkatësisht 26 përqind dhe 22 përqind e të anketuarve pjesërisht pajtohen me deklaratën. Në anën tjetër, qëndrimet të cilat më së shumti u miratuan nga rreth 90 përqind



Grafiku 31

e të anketuarve ishin që shteti duhet “të sigurojë kujdes shëndetësor të përshtatshëm për të sëmurët”, dhe shteti duhet “të sigurojë ndihmë financiare për njerëzit me aftësi të kufizuara”. Përkatësisht 89 përqind dhe 91 përqind e qytetarëve u pajtuan plotësisht me këto qëndrime. Duket sikur qytetarët janë më të ndjeshëm kur është fjala për ato kategori sociale të cilat janë perceptuar si më të rrezikuara dhe më paktë afta për të siguruar shërbime për veten e tyre.

Kur u pyetën specifikisht për *shkallën e angazhimit të shtetit në politikat e rishpërndarjes*, shumica e të anketuarve (43 përqind) u përgjigj se shteti shqiptar duhet “të ketë një rol aktiv në zvogëlimin e hendekut midis të pasurve dhe të varfërve”, 35 përqind e të anketuarve u përgjigj se shteti shqiptar duhet “të angazhohet në mënyrë të moderuar në politikat e rishpërndarjes”, ndërsa 12 përqind u përgjigj se “hendeku midis të pasurve dhe të varfërve nuk është një çështje që duhet ta zgjidhë shteti”. Në këto kushte, edhe pse në shkallë të ndryshme, shumica e të anketurve presin që shteti të ketë një rol rishpërndarës aktiv.




Grafiku 32

Variacioni në varësi të të ardhurave dhe profilit ideologjik

Kur bëhet fjalë për rolin e shtetit në politikat e rishpërndarjes, nga grafiku 32.1, mund të vërehet se ka variacion të konsiderueshëm në


varësi të të ardhurave. Kështu, me rritjen e të ardhurave të anketuarit shfaqin tendencën të miratojnë gjithnjë e më pak qëndrimin se shteti shqiptar duhet “të ketë një rol aktiv rishpërndarës në mënyrë që të zvogëlojë hendekun midis të pasurve dhe të varfërve” (51 përqind e të anketuarve me ‘0-30 mijë Lekë’ të ardhura pajtohet kundrejt 29 përqind e të intervistuarve me ‘mbi 160 mijë Lekë’ të ardhura). Nga ana tjetër, me rritjen e të ardhurave të anketuarit kanë tendencën për të miratuar më shumë qëndrimin se shteti shqiptar duhet “të angazhohet në mënyrë të moderuar në politikat e rishpërndarjes” dhe se “hendeku midis të pasurve dhe të varfërve nuk është një çështje që duhet ta zgjidhë shteti”. Kjo pritej të ishte një pyetje e ndjeshme ndaj nivelit të të ardhurave.



Grafiku 32.1

Në varësi të profilit ideologjik, ka një nivel variacioni që vlen të vihet në pah. Kështu, duke lëvizur nga e majta në të djathtë të spektrit politik, të anketuarit priren të bien më pak dakord me pohimin se shteti shqiptar duhet “të ketë një rol aktiv në zvogëlimin e hendekut midis të pasurve dhe të varfërve”, por kjo tendencë përmbysset në pohimin se “hendeku midis të pasurve dhe të varfërve nuk është një çështje që duhet ta zgjidhë shteti”, ku të anketuarit e qendrës së djathtë dhe të së djathtës, kanë tendencën të mbështesin këtë qëndrim të fundit më shumë se të anketuarit e përkatësive të tjera ideologjike, edhe pse në përqindje ky është

opsioni i tyre më pak i parapëlqyer në raport me dy të tjerët.




Grafiku 32.2

Nënkapitulli VI: VLERËSIMI I RISKUT

Ky nënkapitull përmbyllës vlerëson *problemet më të mëdha të perceptuara nga qytetarët* në lidhje me shqiptarët në përgjithësi dhe veten e tyre. Përveç krahasimit horizontal brenda kapitullit ndërmjet asaj çfarë qytetarët shikojnë si problem të shqiptarëve në përgjithësi dhe asaj çfarë shikojnë si problem të tyrin personal, ky nënkapitull shërben edhe si një bazë e mirë për të bërë një krahasim vertikal me nënkapitujt e tjerë në mënyrë që të vlerësohen pakënaqësitë kryesore të qytetarëve si dhe qasja e tyre kundrejt institucioneve, besimit, ofrimit të shërbimeve publike, rolit të shtetit, etj.


Qytetarët u pyetën fillimisht në lidhje me atë çfarë ata konsiderojnë si *problem për qytetarët shqiptar*. Është e rëndësishme të vërehet se në këtë pyetje qytetarët mund të zgjidhnin më shumë se një



Grafiku 33

alternative. Një shumicë e madhe e të anketuarve (87 përqind) zgjedhën papunësinë si problem për qytetarët shqiptar sot, e ndjekur kjo nga varfëria me 75 përqind. Rreth gjysma e të intervistuarve mendon se standardet e ulëta të drejtësisë (53 përqind), standardet e ulëta të kujdesit shëndetësor (48 përqind) si dhe krimi, dhuna dhe/ose trafikimi (45 përqind) janë problemet më të mëdha të shqiptarëve sot. Niveli i ulët i edukimit, lojrat e fatit, mungesa e rendit publik dhe shkelja e të drejtave të njeriut u cilësuan si probleme nga rreth 1/3 e të anketuarve për secilën. Rreth 20-25 përqind e të anketuarve mendon se infrastruktura e keqe, mundësitë e pakta për biznes, mungesa e solidaritetit social si dhe policia jo efektive janë probleme. Ndërkohë, 12 përqind e tyre mendon se problem është mungesa e lirisë.


Kur vijnë tek përcaktimi i problemeve personale më shqetësuese, ka një nivel të konsiderueshëm qëndrueshmërie midis atyre çfarë perceptohen si probleme për qytetarët në përgjithësi dhe atyre çfarë



Grafiku 34

perceptohen si probleme personale. Kështu, tri problemet personale më shqetësuese për të anketuarit — të ardhura të pakta me 29 përqind, papunësia me 22 përqind dhe varfëria me 12 përqind — janë shumë të ngjashme me atë çfarë qytetarët konsiderojnë edhe si probleme të qytetarëve të tjerë shqiptar. Për më tepër, probleme të tjera që shqetësojnë rreth 5-7 përqind të të anketuarve personalisht janë siguria në punë, nivelet e larta të krimit dhe/apo mungesa e sigurisë, standardet e ulëta të kujdesit shëndetësor dhe çështjet e pronësisë.

Nëse rezultatet e mësipërme nga sondazhi i sivjetshëm krahasohen me sondazhin e vitit 2013, shikojmë një panoramë pothuajse identike të problemeve personale të perceptuara nga qytetarët. Kështu, të ardhurat e pakta, me 28 përqind; papunësia, me 25 përqind; dhe varfëria, me 13 përqind janë problemet më të cilësuar, të ndjekuara nga nivelet e krimit dhe siguria e punës.



Grafiku 35²³

23. Përgjigjet nga sondazhi *Gjendja e demokracisë shqiptare në prag të zgjedhjeve të përgjithshme 2013*.

Aneksi 1: Pyetësi

I. PROFILI I PËRGJITHSHËM

1. Gjinia

1 Mashkull 2 Femër

2. Grupmosha

- 1 18- 29
- 2 30 -39
- 3 40-49
- 4 50-69
- 5 Mbi 70

3. Niveli arsimor

- 1 Pa arsim
- 2 Arsim fillor
- 3 Arsim 8-vjeçar
- 4 Arsim i mesëm
- 5 Arsim i lartë
- 6 Master/PhD

4. Sa janë të ardhurat mujore të familjes suaj?

- 1 0- 30.000 Lekë
- 2 30.001- 60.000 Lekë
- 3 60.001- 100.000 Lekë
- 4 100.001- 160.000 Lekë
- 5 Mbi 160.000 Lekë

5. Cili është statusi juaj i punësimit?

- 1 I/e punësuar
- 2 I/e vetëpunësuar
- 3 I/e papunë
- 4 Student
- 5 Në pension
- 99 Pa përgjigje

6. Si do ta përcaktonit profilin tuaj ideologjik?

1	<i>I/e majtë</i>
2	<i>Qendër e majtë</i>
3	<i>Qendër</i>
4	<i>Qendër e djathtë</i>
5	<i>I/e djathtë</i>
6	Asnjë
99	Pa përgjigje

II. DEMOKRACIA DHE EKONOMIA E TREGUT

7. Si do ta vlerësonit nivelin e demokracisë në Shqipëri sot? (Zgjidhni vetëm një alternativë)

1	Shqipëri është një vend plotësisht jo demokratik
2	Shqipëria është më shumë jo demokraci sesa demokraci
3	Shqipëria është më shumë demokraci sesa jo demokraci
4	Shqipëri është një vend plotësisht demokratik
99	Nuk e di / pa përgjigje

8. A mendoni se ekonomia e tregut është sistemi i duhur ekonomik për Shqipërinë? (Zgjidhni vetëm një alternativë)

1. PO

0. JO

99. Nuk e di

9. Sipas mendimit tuaj (Përgjigjuni me Po ose Jo):

1. Shteti shqiptar duhet të ndërhyjë në ekonomi për të përcaktuar çmimet, për të mbrojtur disa biznese strategjike, etj.	
2. Shteti shqiptar duhet të rregullojë marrëdhëniet tregtare, rregullat e përgjithshme të konkurrencës dhe tregtisë.	
3. Shteti shqiptar duhet të ndërhyjë sa më pak apo të jetë sa më pak prezent në ekonomi, pasi ekonomia e tregut vetërregullohet.	

10. Nga kush duhet të merren vendimet mbi menaxhimin e shërbimeve publike dhe mbi prioritetet (Zgjidhni vetëm një alternativë):

1	Vetëm nga ekspertët dhe politikbërësit që merren me shërbimet publike dhe i dinë më mirë këto punë
2	Nga ekspertët dhe politikbërësit në bashkëpunim me publikun e gjerë apo grupet komunitare, të cilat përfitojnë dhe kontribuojnë për këto shërbime
3	Komuniteti dhe publiku në përgjithësi duhet të jenë shumë më të përfshirë në formësimin e këtyre shërbimeve duke u treguar prioritetet politikbërësve

11. Sa influencë kini ju mbi vendimet rreth shërbimeve publike:

	1. Shumë	2. Disi	3. Pak	4. Aspak
Në nivel lokal				
Në nivel kombëtar				

12. Me cilin nga pohimet e mëposhtme bini dakord?

	1. Po	0. Jo	99. Nuk e di
Sistemi gjyqësor në Shqipëri jep drejtësi			
Qytetarët duhet të kenë miqësi personale për të fituar drejtësi			
Qytetarët duhet të kenë lidhje politike që të fitojnë të drejtën			
Qytetarët duhet të paguajnë ryshfet/ të korruptojnë gjyqtarët/prokurorët që të fitojnë drejtësi			

13. Në çfarë mase bini dakord me pohimet e mëposhtme (zgjidhni vetëm një alternativë për pohim):

	4. Plotësisht dakord	3. Disi	2. Pak	1. Aspak	99. Nuk e di/Pa përgjigje
Sot shteti shqiptar funksionon siç duhet					
Shteti shqiptar është prezent në të gjithë territorin e Shqipërisë					
Shteti ligjor është prezent në të gjithë territorin e Shqipërisë					
Shteti shqiptar respekton të drejta e njeriut					
Shteti shqiptar u ofron të mirat publike bazë qytetarëve të vet					

III. NIVELI I BESIMIT

14. Më poshtë është një listë institucionesh në Shqipëri. Sa besim kini në secilin prej tyre? (zgjidhni vetëm një alternativë për çdo institucion):

	4. Shumë	3. Disi	2. Pak	1. Aspak	99. Nuk e di/Pa përgjigje
1. Presidenti					
2. Qeveria					
3. Kryeministri					
4. Opozita					
5. Prokurori i Përgjithshëm					
6. Policia					
7. Partitë politike					
8. Gjykatat					
9. Institucionet e arsimit privat					
10. Institucionet e arsimit publik					
11. Spitalet private					
12. Spitalet publike					
13. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve					
14. Shoqëria Civile					
15. Media					
16. Institucionet fetare					
17. Forcat e armatosura					
18. Shërbimet e inteligjencës					

IV. KONTRATA KOLEKTIVE DHE DIALOGU SOCIAL

15. Vendimet e rëndësishme mbi pagat, orët e punës dhe të drejtat e të punësuarve në Shqipëri (zgjidhni vetëm një alternativë):

1	Duhet të diskutohen dhe vendosen vetëm nga institucionet publike dhe qeveria/politikëbërësit
2	Duhet të diskutohen dhe vendosen nga qeveria/politikëbërësit në bashkëpunim me sindikatat/organizatat e punëtorëve
3	Duhet të diskutohen dhe vendosen kryesisht nga sindikatat/organizatat e punëtorëve ndërkohë që qeveria/politikëbërësit janë pjesa fundore e procesit
99	Nuk e di

16. Sot në Shqipëri sindikatat (Përgjigju me PO ose JO):

	1. Po	0. Jo	99. Nuk e di
1. Nuk janë ekzistuese			
2. Ekzistojnë, por nuk janë efektive në mbështetjen e të drejtave të të punësuarve			
3. Aktive dhe efektive në mbrojtjen e të drejtave të të punësuarve			
4. Nuk janë të pavarura nga partitë politike apo grupet e tjera			

V. SHËRBIMET PUBLIKE DHE ROLI I SHTETIT

17. Kush mendoni se duhet të jetë ofruesi kryesor i këtyre shërbimeve:

	1 Shteti	2 Privati	3 Të tjerë (familja, NGO)
Punë			
Arsim			
Kujdes shëndetësor			

Mbrojtje sociale/shërbime			
Drejtësi			
Siguri publike			
Infrastrukturë			
Strehim			
Furnizim me ujë			
Energji elektrike			
Postë dhe telekomunikacion			
Shanse të barabarta			
Tjetër (specifiko)			

18. Sipas opinionit tuaj, arsimi në Shqipëri duhet të jetë (zgjidhni vetëm një alternativë):

1. Publik dhe i financuar nga taksat publike
 2. Publik dhe i financuar pjesërisht nga taksat publike dhe pjesërisht nga pagesat e përdoruesve të shërbimit
 3. I financuar nga taksat publike, por i menaxhuar nga organizata/kompani private
 4. Privat dhe i financuar me pagesat e çdo qytetari që e përdor shërbimin
99. Nuk e di/Pa përgjigje

19. Sipas opinionit tuaj, kujdesi shëndetësor në Shqipëri duhet të jetë (zgjidhni vetëm një alternativë):

1. Publik dhe i financuar nga taksat publike
2. Publik dhe i financuar pjesërisht nga taksat publike dhe pjesërisht nga pagesat e përdoruesve të shërbimit
3. I financuar nga taksat publik,e por i menaxhuar nga organizata/kompani private

4. Privat dhe i financuar me pagesat e çdo qytetari që e përdor shërbimin

99. Nuk e di/Pa përgjigje

20. Sipas opinionit tuaj, pensionet në Shqipëri duhet të jenë (zgjidhni vetëm një alternativë):

1. Të menaxhuara nga sektori publik dhe të financuara nga kontributet sociale siç janë aktualisht

2. Të menaxhuara nga sektori publik dhe të financuara nga kontributet sociale, por tu jepet e drejta e zgjedhjes atyre që duan të kontribuojnë pjesërisht në skema private pensionesh

3. Të funksionojnë plotësisht sipas skemave dhe kontributeve private

99. Nuk e di

21. A jeni të kënaqur me standardet e këtyre shërbimeve publike, të ofruara nga shteti në Shqipëri (zgjidhni vetëm një alternativë për çdo shërbim):

	4. Shumë i/e kënaqur	3. I/e kënaqur	2. Jo dhe aq i/e kënaqur	1. I pakënaqur	99. Nuk e di/pa përgjigje
Arsimi					
Kujdesi shëndetësor					
Drejtësia					
Siguria publike					
Infrastruktura					
Furnizimi me ujë					

Energjia elektrike					
Pensionet					
Nxjtja e punësimit					
Çështjet e biznesit (regjistrimi, autoritetet taksuese, aftësia konkurruese)					
Mbrojtja e konsumatorit					
Mbrojtja e të drejtave të njeriut (mbrojtja e grupeve të dobëta/ pakicave nga diskriminimi)					
Menaxhimi i mbetjeve					

22. Cili ofron cilësi më të mirë për shërbimet e mëposhtme?

	<i>1 Institucionet publike</i>	<i>2 Sektori privat</i>	<i>99 Nuk e di</i>
Arsim			
Kujdes shëndetësor			
Drejtësi			
Siguri publike			
Nxjtje të punësimit			
Pensione			

23.A jeni pro apo kundër me pohimet e mëposhtme:

	PO	JO
1. Të gjitha ndërmarrjet publike në Shqipëri duhet të privatizohen		
2. Privatizimi i bën ndërmarrjet shtetërore më efektive në ofrimin e shërbimeve		
3. Shteti shqiptar duhet të kontraktojë kompani private menaxhuese pa hequr dorë nga të drejtat e pronësisë mbi ndërmarrjet publike		
4. Asnjë proces privatizimi i çfarëdo lloji qoftë nuk duhet të ndërmerret për menaxhimin apo pronësinë e ndërmarrjeve publike		

24. A jeni pro apo kundër me pohimet e mëposhtme:

	PO	JO
1. Niveli i taksave duhet të rritet nëse kjo gjë do të rriste cilësinë e shërbimeve		
2. Niveli i taksave duhet të ulet pasi unë dua t'i ofroj vetë shërbimet bazë për veten dhe familjen time		
3. Unë do të isha i/e gatshme të kontribuoj me mjete jo-financiare (vullnetarizëm, shërbime komunitare, etj)		
4. Kush fiton më shumë duhet të paguajë më shumë		
5. Taksat mbi të ardhurat duhet të kenë një normë fikse pavarësisht nga niveli i të ardhurave		

VI. SHANSET E BARABARTA DHE MBROJTJA SOCIALE**25. Në një shoqëri të drejtë (zgjidhni vetëm një alternativë):**

1. Gjithkush shpërblehet me atë sasi pasurie në varësi të aftësive dhe kontributit
2. Kush paguan më shumë merr më shumë, por disa grupe të dobëta të shoqërisë duhet të asistohen nga shteti

3. Askush nuk lihet pa shërbime publike bazë, pavarësisht nga aftësia për të kontribuar

99. Nuk e di/ pa përgjigje

26. Si do ta vlerësonit asistencën për të papunët aktualisht në Shqipëri? (Zgjidhni vetëm një alternativë):

1. Shuma që jepet për çdo familje është shumë e vogël

2. Shuma që jepet për çdo familje është shumë e lartë

3. Shuma që jepet për çdo familje është aq sa duhet

99. Nuk e di/ pa përgjigje

27. Në çfarë mase bini dakord ose jo me pohimet e mëposhtme:

Shteti shqiptar duhet të ofrojë:	Plotësisht	Pjesërisht	Aspak
1 Një sasi të mjaftueshme të ardhurash në moshë të thyer			
2 Asistencë financiare gjatë periudhave të papunësisë			
3 Asistencë financiare për familjet e varfra			
4 Asistencë financiare për njerëzit me aftësi të kufizuara			
5 Punë për këdo që dëshiron të punojë			
6 Kujdes të përshtatshëm shëndetësor për të sëmurët			
7 Shërbime të mjaftueshme mbajtjen e fëmijëve për prindërit që punojnë (kopshte, çerdhe)			
8 Leje lindjeje të paguar			
9 Mbrojtje dhe mundësi të veçanta për grupet e dobëta në shoqëri			

28. Shteti shqiptar (zgjidhni vetëm një alternativë):

1. Duhet të ketë një rol aktiv rishpërndarës në mënyrë që të zvogëlojë diferencën/hendekun midis të pasurve dhe të varfërve
 2. Duhet të angazhohet në një masë të moderuar në politikat e rishpërndarjes
 3. Diferenca/hendeku midis të pasurve dhe të varfërve nuk është një çështje që duhet ta zgjidhë shteti
99. Nuk e di

VII. VLERËSIMI I RISKUT**29. Sot, cilin nga problemet e mëposhtme e shihni shqetësues për qytetarët shqiptarë? (mund të zgjidhni dhe më shumë se një alternativë):**

1. Papunësinë
2. Varfërinë
3. Mungesën e rendit publik/sigurisë
4. Policinë jo-efektive
5. Nivelin e ulët i arsimit
6. Standardet e ulëta të drejtësisë
7. Shkeljen e të drejtave të njeriut
8. Standardet e ulëta të kujdesit shëndetësor
9. Krimin/dhunën/trafikimin
10. Mungesën e lirisë
11. Degradimin e mjedisit
12. Biznesin ilegal/informalitetin/mungesën e mundësive për biznes
13. Kazinotë/kumarin/lojërat e fatit
14. Standardet e ulëta të rrugëve
15. Mungesën e solidaritetit social

16. Tjetër (specifiko)_____

17. Qytetarët nuk kanë probleme

99. Nuk e di/ pa përgjigje

**30. Cila është çështja më shqetësuese për ju personalisht?
(zgjidhni vetëm një alternativë):**

1. Të ardhurat e pakta

2. Varfëria

3. Papunësia

4. Siguria në punë

5. Standardet të ulëta të arsimit

6. Standardet e ulëta të kujdesit shëndetësor

7. Mungesa e shërbimeve sociale

8. Niveli i lartë i krimit/mungesa e sigurisë

9. Dëmet mjedisore/ Mbeturinat/ Ndotja

10. Strehimi

11. Çështjet e pronësisë

12. Nuk kam ndonjë problem

99. Nuk e di/ pa përgjigje

Referencat

Bakke, Elisabeth dhe Ingo Peters (eds.), *20 Years since the Fall of the Berlin Wall: Transitions, State Break-Up and Democratic Politics in Central Europe and Germany*. (Berlin: BWV Berliner Wissenschafts-Verlag, 2012).

Calzada, Inés dhe Eloísa del Pino, Perceived efficacy and citizens' attitudes toward welfare state reform. *International Review of Administrative Sciences*. Volume 74:4. (2008), pp. 555-574.

Cook, Linda J., *Postcommunist Welfare States: Reform politics in Russia and Eastern Europe*. (Ithaca: Cornell University Press, 2007).

Çela, Alba dhe Joana Kosho, *Gjendja e demokracisë shqiptare në prag të zgjedhjeve të përgjithshme 2013*. Albanian Institute for International Studies and Friedrich Ebert Stiftung (Tiranë, 2013).

Eurofund, *European Social Model*. (last updated: May 5, 2011). <http://www.eurofound.europa.eu/areas/industrialrelations/dictionary/definitions/europeansocialmodel.htm>.

European Commission, *White Paper on European Social Policy - A Way Forward for the Union* (COM (94) 333, Brussels, July 27, 1994). http://aei.pitt.edu/1118/1/social_policy_white_paper_COM_94_333_A.pdf.

European Social Survey, *Data and Documentation*. (2014). <http://www.europeansocialsurvey.org/data/>.

Mazniku, Arbjan dhe Geron Kamberi, Stili i jetesës: Demokracia dhe qeverisja, në *Rinia Shqiptare 2011: Mes besimit për të ardhmen dhe dyshimit për të tashmen!*, Friedrich Ebert Stiftung. (Tiranë, 2001), pp. 205-218.

Mishler, William dhe Richard Rose, "Trust, Distrust and Skepticism: Popular Evaluations of Civil and Political Institutions in Post-Communist Societies," *The Journal of Politics*, 59: 2, (May 1997): 418-51.

Pop-Eleches, Grigore dhe Joshua A. Tucker, Communist Socialization and Post-Communist Economic and Political Attitudes, (Paper prepared for presentation at the *Center for the Study of Democratic Politics, Princeton University*, May 9, 2012). <http://www.princeton.edu/csdp/events/Pop-Eleches05102012/Pop-Eleches05102012.pdf>.

Rose, Richard dhe Toni Makkai, "Consensus or dissensus about welfare in post-communist societies?", *European Journal of Political Research*, Volume 28: 2, (September 1995), pp.203–224.

Thorisdottir, Hulda, John T. Jost, Ido Liviatan dhe Patricke Shrout, "Psychological Needs and Values Underlying Left-Right Political Orientation: Cross-National Evidence from Wastern and Western Europe." *Public Opinion Quarterly*, Volume 71:2 (2007), pp. 175-203.

2020 Public Services Trust at RSA, *What do people want, need and expect from public services?* (2010). http://www.ipsos-mori.com/DownloadPublication/1345_sri_what_do_people_want_need_and_expect_from_public_services_110310.pdf.